

VENDIM
Nr. 434, datë 11.7.2018

PËR ETIKETIMIN E USHQIMEVE DHE INFORMIMIN E KONSUMATORIT¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 36, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim të vendosë bazën për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së konsumatorit nëpërmjet informacionit për ushqimin, duke marrë parasysh dallimet në perceptimin e konsumatorëve dhe nevojat e tyre për informacion, si dhe duke siguruar funksionimin normal të tregut.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Ky vendim përcakton parimet e përgjithshme, kërkesat dhe përgjegjësitë kryesore që rregullojnë informacionin për ushqimin dhe, në veçanti, etiketimin e produkteve ushqimore. Ai përcakton mjetet për të garantuar të drejtën për informim të konsumatorëve dhe procedurat për sigurimin e informacionit për ushqimin, duke marrë parasysh nevojën për të siguruar fleksibilitet të mjaftueshëm për t’iu përgjigjur zhvillimeve të ardhshme dhe kërkesave të reja të informimit.

2. Ky vendim zbatohet për:

a) Operatorët e biznesit ushqimor, në të gjitha fazat e zinxhirit ushqimor ku aktiviteti i tyre ka të bëjë me dhënien e informacionit për ushqimin për konsumatorët;

b) Të gjitha ushqimet e destinuar për konsumatorin e fundit, duke përfshirë edhe ushqimet e ofruara nga furnizues masivë ushqimesh dhe ushqime të destinuar për furnizim për shërbimin *catering*;

c) Shërbimet e *catering*-ut të ofruara nga ndërmarrjet e transportit.

3. Ky vendim zbatohet pa cenuar kërkesat e etiketimit të parashikuara në dispozita të veçanta, të zbatueshme për produkte të veçanta ushqimore.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllim të këtij vendimi, termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim. Zbatohen, gjithashtu, përkufizimet specifike, të përcaktuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij vendimi. Ndërsa, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aromatizues”, produkti:

a) Që nuk është përcaktuar për t’u konsumuar si i tillë, i cili është shtuar në ushqim me qëllim që t’i japë ose të modifikojë aromën dhe/ose shijen;

b) I bërë apo i përbërë nga kategoritë: substanca aromatizuese, përgatitje aromatizuese, aromatizues të përfutur nga një proces termik, aromatizues tymues, aromatizues pararendës apo aromatizues të tjerë ose përzierjet e tyre.

2. “Datë e jetëgjatësisë minimale të produktit ushqimor”, data deri në të cilën produkti ushqimor ruan karakteristikat e tij specifike, me kusht që të ruhet në mënyrë të përshtatshme.

3. “Etiketë”, çdo qafore e shkruar, e printuar, e shtypur, e shënuar, e stampuar, e fiksuar ose e ngjitur në ambalazhin ose enën e produktit ushqimor.

¹ Ky vendim është përafruar pjesërisht me:

Rregulloren (BE) nr. 1169/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25 tetor 2011, “Për dhënien e informacionit ushqimor për konsumatorët”, që ndryshon rregulloret (KE) nr. 1924/2006 dhe (KE) nr. 1925/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon direktivën e komisionit 87/250/KEE, direktivën e Këshillit 90/496/KEE, direktivën e komisionit 1999/10/KE, direktivën 2000/13/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, direktivat e komisionit 2002/67/KE dhe 2008/5/KE, dhe rregulloren e komisionit (KE) nr. 608/2004; CELEX 02011R1169; FZ L 304, 22.11.2011, f. 18.

4. “Etiketim”, fjalët, veçoritë, markat tregtare, shenjat dalluese, imazhi ose simboli që lidhet me produktin ushqimor, të vendosura në ambalazhe, dokumente, shënime, etiketa, unaza ose shirita që shoqërojnë ose që i referohen një produkti ushqimor të caktuar.
5. “Emër ligjor”, emri i produktit ushqimor, që parashikohet në legjislacionin, rregulloret dhe dispozitat administrative të zbatueshme në shtetin, në të cilin ai produkt shitet për konsumatorin e fundit ose shërbimet e *catering*-ut.
6. “Emër i zakonshëm”, një emër i njohur nga konsumatorët si emri i produktit ushqimor, pa shpjegime të nevojshme, të mëtejshme.
7. “Emër përshkrues”, një emër që përshkruan produktin ushqimor dhe, nëse është e nevojshme, edhe përdorimin e tij, i cili është i qartë për t’u mundësuar konsumatorëve të njohin natyrën e vërtetë të produktit dhe ta dallojnë atë nga produkte të tjera, me të cilat mund të ngatërrohet.
8. “Enzimë ushqimore”, një produkt i përfutur nga bimë, kafshë ose mikroorganizma apo produkte të tyre, duke përfshirë edhe një produkt të përfutur nga një proces fermentimi, në të cilin janë përdorur mikroorganizma:
- a) Që përmbajnë një ose më shumë enzima, të afta të nxitin një reagim specifik biokimik;
 - b) Të shtuara në ushqim për një qëllim teknologjik, në çdo fazë të prodhimit, përpunimit, përgatitjes, trajtimit, paketimit, transportit ose ruajtjes së ushqimit.
9. “Fushëpamje”, të gjitha anët e ambalazhit, të lexueshme nga një pikë e vetme shikimi.
10. “Fushëpamje kryesore”, fushëpamja e ambalazhit, e cila shikohet me vështrim të parë nga konsumatori në momentin e blerjes dhe mundëson identifikimin e produktit nga konsumatori për nga karakteri, natyra e tij apo dhe nëse është e zbatueshme, për nga emri tregtar. Nëse ambalazhi ka disa fushëpamje kryesore identike, fushëpamja kryesore është ajo që zgjidhet nga operatori i biznesit ushqimor.
11. “Informacion ushqimor”, informacioni për një produkt ushqimor që i jepet konsumatorit të fundit nëpërmjet një etikete, materialeve të tjera shoqëruese ose elementeve të tjera, përfshirë mjetet bashkëkohore të teknologjisë ose komunikimin verbal.
12. “Informacion ushqimor i detyrueshëm”, veçoritë ushqimore që duhet të paraqiten për konsumatorin e fundit, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.
13. “Informacion vullnetar”, çdo informacion jo i detyrueshëm që i ofrohet konsumatorit të fundit pa e orientuar në mënyrë të gabuar, duke i atribuar produktit ushqimor veti, të cilat nuk i ka.
14. “Legjislacioni për informacionin ushqimor”, dispozitat e legjislacionit ushqimor që rregullojnë informacionin ushqimor dhe, në veçanti, etiketimin, përfshirë rregulla të përgjithshme, që zbatohen për të gjitha produktet ushqimore në rrethana të veçanta ose për kategori të caktuara produktesh ushqimore dhe rregulla që zbatohen vetëm për produkte ushqimore specifike.
15. “Lexueshmëri”, pamja fizike e informacionit, e cila e bën atë të kuptueshëm (nga ana pamore) nga popullsia dhe përcaktohet nga elemente të ndryshme, të tilla si, ndër të tjera: madhësia e shkrimit, hapësira ndërmjet shkronjave, hapësira mes rreshtave, trashësia, ngjyra, forma e shkronjave, raporti gjerësi-lartësi i shkronjave, sipërfaqja e materialit dhe kontrasti i konsiderueshëm i tekstit të shtypur me sfondin.
16. “Lëndë ushqyese”, proteina, karbohidrati, yndyra, fibra, natriumi, vitaminat dhe mineralet e renditura në pikën 1, të pjesës A, të shtojcës XIII, të këtij vendimi dhe substancat që i përkasin ose janë përbërëse të njërës prej këtyre kategorive.
17. “Mjet komunikimi në distancë”, çdo mjet komunikimi që, pa praninë fizike të njëkohshme të furnizuesit ose konsumatorit, mund të përdoret për lidhjen e një kontrate ndërmjet këtyre palëve.
18. “Mish”, pjesa e ngrënshme, duke përfshirë edhe gjakun, e kafshëve të mëposhtme,:
- a) Thundrakët shtëpiakë, ku hyjnë gjedhët shtëpiakë (duke përfshirë speciet Bubalus dhe Bizon), derrat, dhentë e dhitë, si dhe njëthundrakët shtëpiakë;
 - b) Shpendët, ku hyjnë shpendët e mbarështuar në fermë, duke përfshirë edhe shpendët që nuk konsiderohen si shtëpiakë, por që mbarështohen në fermë si kafshë shtëpiake, me përjashtim të familjes së strucit;
 - c) Lagomorfët, ku hyjnë lepujt, lepujt e egër dhe brejtësit barngrënës;
 - ç) Kafshët e egra të gjahut, ku hyjnë:
 - i. Thundrakët dhe lagomorfët e egër, si dhe gjitarë të tjerë tokësorë që gjuhen për konsumim nga njeriu dhe konsiderohen si kafshë të egra gjahu, sipas legjislacionit në fuqi, duke përfshirë gjitarë që jetojnë në territore të rrethuara në kushte lirie, të ngjashme me ato të kafshëve të egra të gjahut;
 - ii. Shpendët e egër të gjahut, që gjuhen për konsumim nga njerëzit.
 - d) Kafshë gjahu të rritura në fermë, ku hyjnë kafshë të familjes së strucit dhe gjitarë tokësorë të rritur

në fermë, përveç atyre që përmenden në shkronjën “b” ;

dh) Kafshë të egra, të vogla, gjahu, ku hyjnë shpendë të egër dhe lagomorfë të egër gjahu, që jetojnë të lirë në gjendje të egër;

e) Kafshë të egra, të mëdha, gjahu, ku hyjnë gjitarë tokësorë të egër, që jetojnë të lirë në gjendje të egër dhe që nuk i përkasin përkufizimit të kafshëve të egra, të vogla, të gjahut;

19. “Mish i ndarë në mënyrë mekanike” ose (MNM), produkti i përfutur nga heqja e mishit nga kockat ose prej skeletit të shpendëve, duke përdorur mjete mekanike, me pasojë humbjen apo modifikimin e strukturës së fibrave muskulorë.

20. “Mish i përgatitur”, mishi i freskët, përfshirë mishin e prerë në copëza, të cilit i janë hedhur ushqime, erëza ose aditivë, apo që i është nënshtuar proceseve të pamjaftueshme për të modifikuar strukturën e brendshme të fibrave muskulorë të tij dhe, për pasojë, ka humbur veçoritë e mishit të freskët.

21. “Nanomaterial i prodhuar”, çdo material i prodhuar qëllimisht me një ose disa dimensione të rendit 100 nm e poshtë apo që përbëhet nga pjesë funksionale diskrete, në brendësi ose në sipërfaqe, shumica e të cilave kanë një ose disa dimensione të rendit 100 nm e poshtë, përfshirë strukturat, aglomeratet ose agregatet, që mund të kenë madhësi mbi rendin 100 nm, por që ruajnë veçoritë që janë karakteristike për shkallën nanometrike.

Veçoritë karakteristike të shkallës nanometrike përfshijnë:

a) Veçoritë që lidhen me sipërfaqe specifike të mëdha të materialeve përkatëse;

b) Veçoritë specifike fiziko-kimike, të ndryshme nga vetitë e formës nanometrike të të njëjtit material.

22. “Ndihmës teknologjik”, çdo substancë:

a) E cila nuk konsumohet si ushqim në vetvete;

b) E cila është përdorur me qëllim përpunimit të lëndëve të para, të ushqimeve apo përbërësve të tyre, për të përmbushur një qëllim të caktuar teknologjik gjatë trajtimit apo përpunimit;

c) Prania e mbetjeve ose e derivateve të së cilës mund të rezultojë teknikisht e pashmangshme në produktin përfundimtar, duke siguruar se ajo nuk paraqet rrezik për shëndetin dhe nuk ka efekt teknologjik në produktin përfundimtar.

23. “Notifikim”, njoftimi në formë të shkruar, i bërë nga operatori i biznesit ushqimor pranë drejtorisë rajonale të AKU-së për etiketën e përdorur për çdo produkt ushqimor.

24. “Përpunim”, çdo veprim që shkakton një modifikim thelbësor të produktit fillestar, duke përfshirë trajtimin termik, tymosjen, kripjen, staxhionimin, tharjen, marinimin, ekstraktimin, shtrydhjen apo një kombinim të këtyre proceseve.

25. “Produkte të papërpunuara”, produkte ushqimore që nuk i janë nënshtuar ndonjë trajtimi, përfshirë produktet që janë ndarë, seleksionuar, ndarë në feta, që u janë hequr kockat, të grira, të rrjepura, të copëtuara, të prera, të pastruara, që u është hequr lëkura, të bluara, të mbajtura në frigorifer, të ngrira në ngrirje të thellë apo të shkrira.

26. “Produkte të papërpunuara”, produktet ushqimore të marra nga përpunimi i produkteve të papërpunuara. Produkte të tilla mund të përmbajnë përbërës të nevojshëm për përpunimin e tyre apo për t’u dhënë atyre karakteristika specifike.

27. “Produkte mishi”, produkte të papërpunuara, që rezultojnë nga përpunimi i mishit apo prej përpunimit të mëtejshëm të produkteve të tilla të papërpunuara, në të cilat sipërfaqja e prerë tregon se produkti nuk ka karakteristikat e mishit të freskët.

28. “Produkte peshkimi”, të gjitha kafshët e ujit të kripur ose të ëmbël (me përjashtim të molusqeve të gjalla bivalvore, ekinodermat e gjalla, tunikatet e gjalla, gastropodet e gjalla detare dhe të gjithë gjitarët, zvarranikët dhe bretkosat), që janë të egra ose të zbutura, duke përfshirë edhe të gjitha format, pjesët dhe produktet e ngrënshme të kafshëve të tilla.

29. “Publicitet”, paraqitja në çdo formë e një tregtie, biznesi, zanati apo profesioni, me qëllimin për të promovuar furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, duke përfshirë pasurinë e patundshme, të drejtat dhe detyrimet.

30. “Publicitet çorientues”, çdo publikim, që, në çdo mënyrë, duke përfshirë paraqitjen e tij, mashtron apo ka mundësi të mashtrtojë personat, të cilëve u është drejtuar dhe, për shkak të natyrës së tij mashtruese, të ndikojë në sjelljen e tyre ekonomike ose që, për këto arsye, dëmton ose ka mundësi të dëmtojë konkurrentin.

31. “Publicitet krahasues”, çdo publicitet, që, në mënyrë të qartë ose implikuese, identifikon një konkurrent ose mallra apo shërbime të ofruara nga një konkurrent tjetër.

32. “Produkt ushqimor i ambalazhuar paraprakisht”, njësi e veçantë e produktit ushqimor, e prezantuar si e tillë te konsumatori i fundit dhe te ushqimi social, që përbëhet si nga produkti ushqimor, ashtu edhe nga ambalazhi, në të cilin ai është vendosur përpara se të ofrohet për shitje, pavarësisht faktit

nëse ky ambalazh e mbështjell produktin ushqimor në mënyrë të plotë ose të pjesshme, por, në të gjitha rastet, në mënyrë të atillë që përmbajtja ushqimore mund të mos ndryshohet pa e hapur ose ndërruar ambalazhin. Produkti ushqimor i ambalazhuar paraprakisht nuk përfshin produktet ushqimore të paketuara në ambientet e shitjes, me kërkesë të konsumatorit apo produktet e ambalazuara paraprakisht për shitje direkte.

33. “Përbërës”, çdo substancë ose produkt, duke përfshirë substancat aromatizuese, aditivët ushqimorë, enzimën ushqimore dhe çdo nënpërbërës të një përbërësi të përbërë, të përdorur për prodhimin ose përgatitjen e një produkti ushqimor dhe të pranishëm në produktin përfundimtar, nganjëherë edhe në formë të transformuar. Mbetjet nuk konsiderohen si përbërës.

34. “Përbërës i përbërë”, një përbërës, i cili, në vetvete, është produkt i disa përbërësve.

35. “Përbërës kryesor”, një përbërës ose përbërësi i një produkti ushqimor që përbën mbi 50% të këtij produkti apo, i cili, zakonisht, shoqërohet me emrin e produktit ushqimor dhe i jep karakteristikën këtij produkti dhe, për të cilin, në shumicën e rasteve nevojitet deklarimi sasior.

36. “Stoku”, sasia e produkteve ushqimore vendosur në treg përpara përfundimit të periudhës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

37. “Shteti i origjinës së një produkti ushqimor”, referenca e origjinës së produktit ushqimor, siç përcaktohet në nenet 59 dhe 62 të ligjit nr. 102, datë 31.7.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

38. “Transportues”, substanca e përdorur për të tretur, holluar, shpërndarë ose për të modifikuar fizikisht një aditiv ushqimor ose aromatizues, enzimë ushqimore, lëndë ushqyese dhe/ose substanca të tjera të shtuara për qëllime ushqyese ose fiziologjike në një ushqim, pa ndryshuar funksionin e tij dhe pa ushtruar ndonjë efekt teknologjik, në mënyrë që të lehtësojë trajtimin, aplikimin apo përdorimin e tij.

39. “Ushqim social”, çdo stabiliment (përfshirë një automjet ose një tezgë të lëvizshme apo të palëvizshme), si restorantet, mensat, shkollat, spitalet dhe ndërmarrjet e *catering*-ut, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të biznesit, ushqimi përgatitet për konsum nga konsumatori i fundit.

40. “Vendi i prejardhjes”, çdo vend, i deklaruar si vendi prej nga vjen produkti ushqimor, por që nuk është “shteti i origjinës”. Emri, emri i biznesit ose adresa e operatorit të biznesit ushqimor në etiketë nuk do të përbëjnë tregues të vendit të origjinës ose vendit të prejardhjes së ushqimit, në kuptim të këtij vendimi.

KREU II

PARIME TË PËRGJITHSHME PËR INFORMACIONIN USHQIMOR

Neni 4

Objektiva të përgjithshëm

1. Paraqitja e informacionit ushqimor synon arritjen e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe të interesave të konsumatorëve, duke siguruar që konsumatori i fundit të bëjë zgjedhje të informuara dhe ta përdorë produktin ushqimor në mënyrën e duhur, duke u kushtuar vëmendje të veçantë anëve shëndetësore, ekonomike, mjedisore, sociale dhe etike.

2. Legjislacioni për informacionin ushqimor synon arritjen e lëvizjes së lirë të produkteve ushqimore të prodhuara e të tregtuara në vend, duke pasur parasysh, sipas rastit, nevojën për mbrojtjen e interesave të prodhuesve dhe nxitjen e prodhimit të produkteve cilësore. Etiketimi dhe informacioni ushqimor për produkte e kategori produktesh të veçanta përcaktohet me udhëzime të veçanta të ministrit.

Neni 5

Kërkesat që rregullojnë informacionin ushqimor të detyrueshëm

1. Informacioni ushqimor i detyrueshëm përmban:

a) Informacion për identitetin dhe përbërjen, veçoritë dhe karakteristikat e tjera të produktit ushqimor;
b) Informacion për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve dhe për përdorimin e duhur të produktit ushqimor, duke përfshirë, në veçanti, informacion për:

i. veçoritë në përbërje, që mund të jenë të dëmshme për shëndetin e një grupi të caktuar konsumatorësh;

ii. jetëgjatësinë, ruajtjen dhe përdorimin e duhur;

iii. ndikimin në shëndet, përfshirë rreziqet dhe pasojat që lidhen me konsumin e dëmshëm e të rrezikshëm të një produkti ushqimor;

c) Informacion për karakteristikat e vlerave ushqyese, përfshirë ato me kërkesa të veçanta dietike, për t'u mundësuar konsumatorëve të bëjnë zgjedhje të informuara.

2. Gjatë shqyrtimit të nevojës për informacion ushqimor të detyrueshëm dhe për t'u mundësuar konsumatorëve zgjedhjet e informuara duhet pasur parasysh nevoja e shumicës së konsumatorëve për informacione të caktuara, të cilëve ato i japin vlera të rëndësishme ose e çdo përfitimi të pranuar në përgjithësi për konsumatorin.

KREU III KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR INFORMACIONIN USHQIMOR DHE PËRGJEGJËSITË E OPERATORËVE TË BIZNESIT USHQIMOR

Neni 6 **Kërkesa bazë**

Çdo produkt ushqimor, i përcaktuar të jetë për konsumatorin e fundit ose për shërbimin *catering*, shoqërohet me informacionin ushqimor, në përputhje me këtë vendim.

Neni 7 **Praktikat e informacionit të drejtë**

1. Informacioni ushqimor duhet të orientojë në mënyrë të drejtë konsumatorin:
 - a) Në lidhje me karakteristikat e produktit ushqimor dhe, në veçanti, me natyrën e tij, identitetin, vetitë, përbërjen, sasinë, jetëgjatësinë, shtetin e origjinës apo vendin e prejardhjes, si dhe metodat e përpunimit ose të prodhimit;
 - b) Duke mos i dhënë produktit ushqimor efekte ose veti të cilat ai nuk i ka;
 - c) Duke mos theksuar se produkti ushqimor ka karakteristika të veçanta, për shkak të pranisë ose mungesës së përbërësve dhe/ose lëndëve ushqyese të caktuara, kur, në fakt, të gjitha produktet ushqimore të ngjashme kanë karakteristika të tilla;
 - ç) Duke mos theksuar, nëpërmjet paraqitjes së produkteve ushqimore, përshkrimit ose imazheve, praninë e një ushqimi apo përbërësi të veçantë, ndërkohë që, në të vërtetë, një komponent natyreshëm i pranishëm apo një përbërës që përdoret normalisht në atë produkt ushqimor është zëvendësuar me një komponent apo përbërës tjetër të ndryshëm.
2. Informacioni ushqimor duhet të jetë i saktë, i qartë dhe i lehtë për t'u kuptuar nga konsumatori.
3. Informacioni ushqimor nuk i jep çdo produkti ushqimor vetitë e parandalimit, të trajtimit ose të kurimit të një sëmundjeje njerëzore dhe as nuk u referohet karakteristikave të tilla. Përfundimisht, për ujërat minerale natyrale dhe produktet ushqimore për përdorime të veçanta ushqyese, zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për këto produkte.
4. Pikat 1, 2 dhe 3 zbatohen edhe për:
 - a) Reklamën;
 - b) Paraqitjen e produktit ushqimor, në veçanti për formën e tij, paraqitjen apo ambalazhin dhe materialet e përdorura për ambalazhim, për mënyrën e organizimit të tij dhe për vendin në të cilën shfaqen.

Neni 8 **Përgjegjësitë e operatorit të biznesit ushqimor**

1. Operatori i biznesit ushqimor, përgjegjës për informacionin ushqimor, është operatori nën emrin apo emrin tregtar të të cilit kryhet tregtimi i produktit ushqimor. Në rastin e produkteve ushqimore të importuara, përgjegjës për informacionin ushqimor është importuesi i tij.
2. Operatori i biznesit ushqimor, përgjegjës për informacionin ushqimor, garanton praninë dhe saktësinë e informacionit ushqimor në përputhje me këtë vendim.
3. Operatori i biznesit ushqimor nuk tregton produkte ushqimore, të cilat, në bazë të informacionit që ai zotëron si profesionist, nuk janë në përputhje me kërkesat e dispozitave të legjislacionit në fuqi për informacionin ushqimor.
4. Operatori i biznesit ushqimor, në veprimtarinë e biznesit nën kontrollin e tij nuk modifikon informacionin që shoqëron një produkt ushqimor nëse një modifikim i tillë do të çorientonte konsumatorin e fundit ose do të ulte nivelin e mbrojtjes së konsumatorit e të mundësive të tij për të bërë zgjedhje të duhura. Operatori i biznesit ushqimor është përgjegjës për çdo ndryshim që i bëhet informacionit ushqimor që shoqëron një produkt ushqimor.
5. Operatori i biznesit ushqimor, në veprimtarinë e biznesit nën kontrollin e tij garanton transmetimin e informacionit që lidhet me produktin ushqimor jo të ambalazhuar paraprakisht për konsumatorin e fundit ose për ushqimin social, tek operatori i biznesit ushqimor që e merr produktin ushqimor, në mënyrë që të

mundësohet paraqitja e informacionit ushqimor të detyrueshëm për konsumatorin e fundit.

6. Operatori i biznesit ushqimor, në veprimtarinë e biznesit nën kontrollin e tij, garanton që kërkesat e veçanta, të detyrueshme, sipas neneve 9 e 10, të vendosen në ambalazhin paraprak ose në etiketën e ngjitur në të, apo në dokumentet tregtare, që u referohen produkteve ushqimore. Operatori i biznesit duhet të garantojë që këto dokumente ta shoqërojnë produktin ushqimor, të cilit i referohen ose të dërgohen paraprakisht apo njëkohësisht me dërgesën. Këto dispozita zbatohen në rastet kur produkti ushqimor i paraambalazhuar synohet për:

a) Konsumatorin e fundit, por tregtohet në një fazë para shitjes te konsumatori i fundit. Në këtë fazë nuk përfshihet shitja te shërbimi *catering*;

b) furnizimin e shërbimit *catering*, për përgatitje, përpunim, ndarje ose prerje.

Pavarësisht shkronjës “a”, operatori i biznesit ushqimor garanton, gjithashtu, paraqitjen e veçorive të përmendura në shkronjat “a”, “p”, “g” dhe “h”, të pikës 1, të nenit 9, të këtij vendimi, në paketimin e jashtëm, në të cilin produktet ushqimore të paraambalazhuara ofrohen për tregtim.

7. Operatori i biznesit ushqimor, që ofron për operatorë të tjerë ushqimorë produkte ushqimore që nuk synohen për konsumatorin e fundit ose për shërbimin *catering*, garanton që këta operatorë të biznesit ushqimor të pajisen me informacionin e mjaftueshëm, për t'u mundësuar atyre të përmbushin detyrimet sipas pikës 2, të këtij neni.

8. Operatori i biznesit ushqimor, i cili është përgjegjës për etiketimin e produkteve ushqimore, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1, të këtij neni, bën notifikimin e etiketës për çdo produkt ushqimor pranë drejtorive rajonale të AKU-së.

9. Afati për notifikimin e etiketës është jo më shumë se 15 ditë kalendrike nga pranimi i kërkesës pranë drejtorisë rajonale të AKU-së. Në përfundim të këtij afati, në mungesë të komenteve të marra nga AKU-ja, etiketa konsiderohet e notifikuar. Në rast se AKU-ja propozon çështje për përmirësim në etiketë, etiketa e rishikuar nga operatori i biznesit duhet të notifikohet brenda një afati prej 10 ditësh kalendrike nga pranimi i kërkesës së rishikuar për notifikim.

10. Objekt i notifikimit të etiketës nuk janë shenja, marka, disenjoja, etj., që mund të përbëjnë objekte të pronësisë industriale. Notifikimi nuk përbën mbrojtje të objekteve të pronësisë industriale.

11. Ndalohet përdorimi dhe përfshirja në etiketë e shenjave, emrave, markave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë, emërtimeve të origjinës, të cilët cenojnë të drejta të fituara të pronësisë industriale.

KREU IV INFORMACIONI I DETYRUESHËM USHQIMOR

SEKSIONI 1 PËRMBAJTJA DHE PARAQITJA

Neni 9

Deklarimi i të dhënave të detyrueshme

1. Në përputhje me nenet 10 deri në 35 të këtij vendimi dhe me përjashtimet që përfshihen në këtë kre, është i detyrueshëm deklarimi i të dhënave të mëposhtme:

- a) Emri i produktit ushqimor;
- b) Lista e përbërësve;
- c) Çdo përbërës ose lëndë ndihmëse e përpunimit apo që vjen nga një substancë ose produkt i renditur në shtojcën II, që shkakton alergji ose intoleranca, i përdorur në prodhimin ose përpunimin e produktit ushqimor dhe që është ende i pranishëm në produktin përfundimtar edhe nëse në formë të ndryshuar;
- ç) Sasia e përbërësve ose e kategorive të caktuara të përbërësve sipas rendit zbritës;
- d) Sasia neto e produktit ushqimor;
- dh) Data e jetëgjatësisë minimale ose “të përdoret përpara” datës;
- e) Kushtet e veçanta të ruajtjes dhe/ose kushtet e përdorimit;
- ë) Emri ose emri tregtar dhe adresa e operatorit të biznesit ushqimor, të përmendura në pikën 1, të nenit 8;
- f) Shteti i origjinës ose vendi i prejardhjes, kur parashikohet në nenin 26;
- g) Udhëzimet e përdorimit, kur, në mungesë të tyre, përdorimi i duhur i produktit ushqimor do të ishte i vështirë;
- gj) Për pijet me mbi 1,2% të vëllimit me alkool, fortësinë aktuale alkoolike për vëllim;
- h) Deklaratën e vlerave ushqyese.

2. Veçoritë e përmendura në pikën 1 paraqiten me fjalë dhe numra. Pa rënë ndesh me nenin 35 të këtij vendimi, ato mund të shprehen edhe me anë të piktogrameve ose simboleve.

3. Veçoritë e përmendura në pikën 1 mund të shprehen edhe me anë të piktogrameve ose simboleve në vend të fjalëve apo numrave, duke garantuar që konsumatorët të përfitojnë nga mjetet e tjera të shprehjes së informacionit ushqimor të detyrueshëm, me kushtin që të garantohet nivel i njëjtë i informimit, si në rastin e fjalëve dhe numrave.

Neni 10

Veçori shtesë, të detyrueshme, për lloje dhe kategori specifike të produkteve ushqimore

Përveç veçorive të renditura në pikën 1, të nenit 9 të këtij vendimi, veçoritë shtesë, të detyrueshme, për lloje dhe kategori specifike të produkteve ushqimore, përcaktohen në shtojcën III bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 11

Peshat dhe masat

Dispozitat specifike për peshat dhe masat, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, zbatohen pa rënë ndesh me nenin 9 të këtij vendimi.

Neni 12

Disponueshmëria dhe vendosja e informacionit ushqimor të detyrueshëm

1. Informacioni ushqimor i detyrueshëm për të gjitha produktet ushqimore disponohet dhe aksesohet lirisht, në përputhje me këtë vendim.

2. Në rastin e produktit ushqimor të paraambalazhuar, informacioni ushqimor i detyrueshëm shfaqet direkt në paketimin ose etiketën e ngjitur në të.

3. Për të garantuar që konsumatorët përfitojnë nga mjete të tjera të paraqitjes së informacionit ushqimor të detyrueshëm, që janë më të përshtatshme për disa veçori të caktuara, të detyrueshme dhe me kushtin që të garantohet nivel i njëjtë informimi si në rastin e paketimit apo të etiketës, merren në konsideratë provat për kuptimin e njëjtë nga konsumatorët, në bazë të të cilave veçoritë e caktuara, të detyrueshme, mund të shprehen me mjete të tjera, të ndryshme nga ato në paketim ose në etiketë.

4. Në rastin e produkteve që nuk janë të paraambalazuara zbatohen parashikimet e nenit 40.

Neni 13

Paraqitja e veçorive të detyrueshme

1. Informacioni ushqimor i detyrueshëm shënohet në një vend të dallueshëm, në mënyrë të tillë që të jetë lehtësisht i dukshëm, qartësisht i lexueshëm dhe të mos fshihet. Në asnjë mënyrë ai nuk duhet të jetë i fshehur, i errësuar, të kufizohet apo të ndërpritet nga ndonjë material tjetër i shkruar, imazh apo element ndërhyrës.

2. Pa rënë ndesh me dispozitat specifike të legjislacionit në fuqi, të zbatueshme për produkte ushqimore të veçanta, kur shfaqen në paketim ose në etiketën e ngjitur në të, veçoritë e detyrueshme, të renditura në pikën 1, të nenit 9, printohen në paketim ose në etiketë, në mënyrë të tillë që të garantohet lexueshmëria e qartë, me shkronja me madhësi shkrimi ku lartësia x është e barabartë ose më e madhe se 1,2 mm, siç përcaktohet në shtojcën IV bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Në rastin e paketimit ose të enëve me sipërfaqe totale më të vogël se 80 cm², lartësia x e madhësisë së shkrimit, të përmendur në pikën 2, është e barabartë ose më e madhe se 0,9 mm.

4. Veçoritë e përcaktuara në shkronjat “a”, “d” dhe “gj”, të pikës 1, të nenit 9, shfaqen në të njëjtën fushëpamje.

5. Pika 4 e këtij neni nuk zbatohet në rastet e specifikuar në pikat 1 e 2 të nenit 16.

Neni 14

Shitja në distancë

1. Pa rënë ndesh me kërkesat e informacionit të përcaktuara në nenin 9 të këtij vendimi, në rastin e produkteve ushqimore të para-ambalazuara, të ofruara për shitje nëpërmjet komunikimit në distancë:

a) Informacioni ushqimor i detyrueshëm, përveç veçorive të përcaktuara në shkronjën “dh”, të pikës 1, të nenit 9, jepet përpara përfundimit të blerjes dhe shfaqet në materialin në mbështetje të shitjes në distancë ose jepet nëpërmjet mjeteve të tjera të përshtatshme, të cilat identifikohen qartësisht nga operatori i biznesit ushqimor. Kur përdoren mjete të tjera, të përshtatshme, informacioni ushqimor i detyrueshëm jepet pa vendosjen e kostove shtesë për konsumatorët nga biznesi ushqimor;

b) Të gjitha veçoritë e detyrueshme paraqiten në momentin e dërgesës.

2. Në rastin e produkteve ushqimore jo të paraambalazuara, të ofruara për shitje nëpërmjet komunikimit në distancë, veçoritë e detyrueshme në bazë të nenit 40 paraqiten në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Shkronja “a”, e pikës 1, të këtij neni, nuk zbatohet për produktet ushqimore të ofruara për shitje nëpërmjet makinave automatike të shitjes ose ambienteve tregtare të automatizuara.

Neni 15

Kërkesat për gjuhën

1. Pa rënë ndesh me pikën 3, të nenit 9, informacioni ushqimor i detyrueshëm shfaqet në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga konsumatorët, ku tregtohet produkti ushqimor.

2. Për produktet ushqimore të importuara, deklarimi i të dhënave të informacionit ushqimor duhet të jepet në gjuhën shqipe, në etiketën origjinale ose në kundëretiketë.

3. Pikat 1 dhe 2, të këtij neni, nuk përjashtojnë deklarimin e të dhënave edhe në gjuhë të tjera.

Neni 16

Përjashtimi i disa veçorive të detyrueshme

1. Në rastin e shisheve të qelqit të destinuara për ripërdorim, që shënohen në mënyrë të lexueshme të përhershme, të cilat nuk kanë etiketë, unazë ose shirit, janë të detyrueshme vetëm veçoritë e përmendura në shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” e “h”, të pikës 1, të nenit 9.

2. Në rastin e paketimit ose të enëve me sipërfaqe më të vogël se 10 cm², janë të detyrueshme për t'u vendosur në paketim ose në etiketë vetëm veçoritë e renditura në shkronjat “a”, “c”, “d” e “dh”, të pikës 1, të nenit 9. Veçoritë e përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 9, paraqiten nëpërmjet mjeteve të tjera dhe me kërkesë të konsumatorit.

3. Pa cenuar dispozitat e tjera të legjislacionit në fuqi, që kërkojnë një deklaratë të detyrueshme të vlerave ushqyese, deklarata e përmendur në shkronjën “h”, të pikës 1, të nenit 9, nuk është e detyrueshme për produktet ushqimore të renditura në shtojcën V bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Pa rënë ndesh me dispozitat e tjera të legjislacionit në fuqi, që kërkojnë një listë të përbërësve ose një deklaratë të detyrueshme të vlerave ushqyese, veçoritë e përmendura në shkronjat “b” dhe “h”, të pikës 1, të nenit 9, nuk janë të detyrueshme për pijet me mbi 1,2% të vëllimit me alkool.

SEKSIONI 2

PARAQITJA E DETAJUAR PËR VEÇORITË E DETYRUESHME

Neni 17

Emri i produktit ushqimor

1. Emri i produktit ushqimor duhet të jetë emri i tij ligjor. Në mungesë të këtij emri, emri i produktit ushqimor do të jetë emri i tij i zakonshëm ose, nëse nuk ka emër të zakonshëm apo emri i zakonshëm nuk përdoret, duhet të jepet një emër përshkrues i produktit ushqimor.

2. Lejohet përdorimi i emrit të produktit ushqimor me të cilin produkti është prodhuar dhe tregtuar ligjërisht në shtetin e prodhimit të këtij produkti. Në rastin kur zbatimi i dispozitave të tjera të këtij vendimi, veçanërisht i atyre të përcaktuara në nenin 9, nuk do të mundësonte që konsumatorët të njohin natyrën e vërtetë të produktit ushqimor dhe ta dallojnë atë nga produkte të tjera ushqimore me të cilat mund të ngatërrohet, emri i produktit ushqimor shoqërohet me informacione të tjera përshkruese, që shfaqen në afërsi të emrit.

3. Në raste kur emri i produktit ushqimor në shtetin e prodhimit të tij nuk përdoret në Shqipëri ose produkti me këtë emër nga vendi i prodhimit është shumë i ndryshëm për sa u përket përbërjes dhe prodhimit të tij nga produkti ushqimor i njohur me këtë emër në vendin tonë, importuesi duhet të japë informacionin e saktë për konsumatorët në rastet kur për këtë produkt nuk garantohej informacioni i saktë, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Emri i produktit ushqimor nuk zëvendësohet me një emër të mbrojtur si pronësi intelektuale, emër tregtar ose emër joshës.

5. Dispozitat specifike për emrin e produktit ushqimor dhe veçoritë që e shoqërojnë atë përcaktohen në shtojcën VI bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 18

Lista e përbërësve

1. Lista e përbërësve duhet të ketë një titull të dukshëm, që përfshin ose përbëhet nga fjala “përbërësit”. Ajo duhet të përfshijë të gjithë përbërësit e produktit ushqimor, në rendin zbritës të peshës, siç janë regjistruar në kohën e përdorimit të tyre në prodhimin e produktit ushqimor.

2. Përbërësit përcaktohen sipas emrit të tyre specifik, kur është e zbatueshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 17 dhe shtojcën VI bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Të gjithë përbërësit e pranishëm në formën e nanomaterialeve të prodhuara duhet të shënohen qartë në listën e përbërësve. Emrat e këtyre përbërësve pasohen nga fjala “nano” në kllapa.

4. Rregullat teknike për zbatimin e pikave 1 dhe 2 të këtij neni përcaktohen në shtojcën VII bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 19

Përfshirja nga lista e përbërësve

Përfshirja paraqitja e listës së përbërësve për produktet e mëposhtme ushqimore:

a) Frutat dhe perimet e freskëta, përfshirë patatet, të cilat nuk janë qëruar, prerë ose trajtuar në mënyrë të ngjashme;

b) Ujin e gazuar, në përshkrimin e të cilit deklarohet kjo karakteristikë;

c) Uthullat e fermentuara, të përfuara nga një produkt i vetëm bazë, në rast se në të nuk është shtuar asnjë përbërës tjetër;

ç) Djathin, gjalpin, qumështin dhe kremën e fermentuar, me kusht që në këto produkte të mos jetë shtuar asnjë përbërës tjetër përveç produkteve laktike, enzimeve apo kulturave të mikro-organizmave, të domosdoshme për prodhim ose kripës së nevojshme për prodhimin e djathërave, përveç djathërave të njomë dhe atyre të përpunuar;

d) Produktet ushqimore që kanë në vetvete vetëm një përbërës, kur:

i. emri i produktit ushqimor është i njëjtë me emrin e përbërësit;

ii. emri i produktit ushqimor lejon që natyra e përbërësit të identifikohet lehtë.

Neni 20

Përfshirja e përbërësve të produktit ushqimor nga lista e përbërësve

Pa rënë ndesh me nenin 21, nuk nevojiten të përfshihen në listën e përbërësve të një produkti ushqimor përbërësit e mëposhtëm:

a) Elementet e një përbërësi që kanë qenë përkohësisht të ndara gjatë procesit të prodhimit dhe më vonë janë përfshirë sërish në ushqim, por duke mos e kaluar sasinë e tyre fillestare;

b) Aditivët ushqimorë dhe enzimat ushqimore:

i. prania e të cilëve në një produkt të caktuar ushqimor i detyrohet vetëm faktit që aditivët ndodheshin në një ose më shumë përbërës të këtij produkti, në përputhje me parimin e transferimit, të përmendur në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 18, të udhëzimit nr. 18, datë 17.11.2010, i ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, “Për aditivët ushqimorë të përdorur në produktet ushqimore”, me kusht që ato të mos kenë ndonjë funksion teknologjik në produktin përfundimtar;

ii. që janë përdorur si lëndë ndihmëse të përpunimit.

c) Ndhimësit teknologjikë dhe substancat që nuk janë aditivë, por të cilët janë përdorur në të njëjtën mënyrë dhe për të njëjtin qëllim si ndihmësit teknologjikë dhe në sasi të nevojshme;

ç) Substancat që nuk janë aditivë, por që janë përdorur në të njëjtën mënyrë dhe për të njëjtin qëllim si lëndët ndihmëse në përpunim dhe që janë akoma të pranishëm në produktin final edhe nëse paraqiten në formë të ndryshuar;

d) Uji:

i. kur përdoret gjatë procesit të prodhimit vetëm për rikthimin e një përbërësi të përdorur në formë të përqendruar ose të dehidratuar;

ii. në rastin e një mjedisi të lëngshëm, që nuk konsumohet normalisht.

Neni 21

Etiketimi i substancave ose i produkteve të caktuara që shkaktojnë alergji ose intolerancë

1. Pa rënë ndesh me nenin 41, të dhënat e përmendura në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 9, përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) Deklarohen në listën e përbërësve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 18,

me referencë të qartë të emrit të substancës ose të produktit, siç renditet në shtojcën II;

b) Theksohet emri i substancës ose i produktit të renditur në shtojcën II, nëpërmjet një radhitjeje që e dallon atë qartësisht nga pjesa tjetër e listës së përbërësve, për shembull, nëpërmjet shkrimit, stilit ose ngjyrës së sfondit.

2. Në mungesë të listës së përbërësve, deklarimi i veçorive të përmendura në shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 9, përbëhet nga fjala “përmban”, e shoqëruar nga emri i substancës ose produktit, të renditur në shtojcën II bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kur disa përbërës ose lëndë ndihmëse të përpunimit të një produkti ushqimor vijnë nga një substancë ose produkt i vetëm, i renditur në shtojcën II, në etiketë duhet të deklarohet qartë çdo përbërës ose lëndë ndihmëse e përpunimit.

4. Deklarimi i të dhënave të përmendura në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 9, nuk do të kërkohet në rastet kur emri i një produkti ushqimor i referohet qartësisht substancës ose produktit në fjalë.

Neni 22

Deklarimi sasior i përbërësve

1. Deklarimi i sasisë së një përbërësi ose kategorie përbërësish të përdorur në prodhimin ose përpunimin e produktit ushqimor është i detyrueshëm, kur përbërësi ose kategoria e përbërësve:

a) Shfaqet me emrin me të cilin shitet produkti ushqimor ose është zakonisht i njohur me atë emër nga konsumatori;

b) Është vendosur në etiketë me anë të fjalëve, pikturave ose grafikëve;

c) Është thelbësor për të karakterizuar një produkt ushqimor dhe për ta dalluar atë nga produkti me të cilin mund të ngatërrohet për shkak të emrit ose të pamjes së jashtme.

2. Rregullat teknike për zbatimin e pikës 1 të këtij neni, duke përfshirë rastet specifike kur deklarimi sasior i disa përbërësve të caktuar nuk është i detyrueshëm, përcaktohen në shtojcën VIII bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 23

Sasia neto

1. Sasia neto e një ushqimi shprehet në litra, centilitra, mililitra, kilogramë ose gramë:

a) Në njësi vëllimore, në rastin e produkteve të lëngshme;

b) Në njësi mase, në rastin e produkteve të tjera.

2. Rregullat teknike për zbatimin e pikës 1 të këtij neni, duke përfshirë rastet specifike kur deklarimi i sasisë neto nuk është i detyrueshëm, përcaktohen në shtojcën IX bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 24

Data e jetëgjatësisë minimale, “të përdoret përpara” datës dhe data e ngrirjes

1. Në rastet e produkteve ushqimore, që nga pikëpamja mikrobiologjike kanë shkallë të lartë të prishjes dhe, si rrjedhojë, pas një periudhe të shkurtër kohe paraqesin një rrezik të menjëhershëm për shëndetin e konsumatorit, data e jetëgjatësisë minimale do të zëvendësohet me fjalët “të përdoret përpara datës” ose “të përdoret deri më”. Pas datës së vendosur pranë këtyre përcaktimeve një produkt ushqimor konsiderohet i pasigurt.

2. Data e saktë shprehet në përputhje me shtojcën X.

Neni 25

Kushtet e ruajtjes dhe të përdorimit

1. Në rastet kur për ruajtjen e produkteve ushqimore nevojiten kushte specifike ruajtjeje dhe/ose përdorimi, këto kushte duhet të deklarohen.

2. Për të mundësuar ruajtjen ose përdorimin e duhur të produktit ushqimor pas hapjes së paketimit, kushtet e ruajtjes dhe/ose afati kohor për konsumim duhet të deklarohen.

Neni 26

Shteti i origjinës ose vendi i prejardhjes

1. Ky nen zbatohet pa rënë ndesh me kërkesat për etiketimin, të parashikuara në dispozita specifike për produktet ushqimore tradicionale dhe për përcaktimin e origjinës e të mbrojtjes së treguesve gjeografikë të produkteve ushqimore.

2. Deklarimi i shtetit të origjinës ose i vendit të prejardhjes është i detyrueshëm:

- a) Kur mosdeklarimi i tyre mund të çorientojë konsumatorin në lidhje me vendin e saktë të origjinës ose vendin e saktë të prejardhjes së produktit ushqimor, veçanërisht nëse informacioni që shoqëron produktin ose etiketa, në tërësi, do të nënkuptonte vend të ndryshëm origjine apo vend të ndryshëm prejardhjeje;
- b) Për mishin që përfshihet në kodet (CN) të Nomenklaturës së Kombinar, të renditur në shtojcën XI;
- c) Për llojet e mishit të ndryshme nga mishit i vëçit dhe ato të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 2;
- ç) Për qumështin;
- d) Për qumështin e përdorur si përbërës në produktet e bulmetit;
- dh) Për produktet ushqimore të papërpunuara;
- e) Për produktet me një përbërës të vetëm;
- ë) Për përbërësit që përfaqësojnë mbi 50% të produktit ushqimor;
- f) Për përdorimin e mishit si përbërës.

3. Në rastin kur vendi i origjinës ose vendi i prejardhjes së një produkti ushqimor deklarohet dhe nuk është i njëjtë me atë të përbërësit kryesor:

- a) Duhet të deklarohet, gjithashtu, edhe vendi i origjinës ose vendi i prejardhjes së përbërësit kryesor;
- b) Duhet të deklarohet që vendi i origjinës ose vendi i prejardhjes së përbërësit kryesor është i ndryshëm nga ai i produktit ushqimor;
- c) Në rastet kur produkti ushqimor importohet dhe ambalazhohet në vendin tonë, duhet të shënohet vendi i origjinës ose vendi i prejardhjes së produktit ushqimor dhe emri i operatorit të biznesit ushqimor që e ka ambalazhuar.

Neni 27

Udhëzimet e përdorimit

Udhëzimet e përdorimit të një produkti ushqimor paraqiten në mënyrë të tillë që të mundësohet përdorimi i duhur i tij.

Neni 28

Fortësia alkoolike

1. Rregullat për deklarimin e fortësisë alkoolike për vëllim, në rastin e produkteve të klasifikuara në kodin CN 2204, janë ato të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin dhe publikimin zyrtar të nomenklaturës së kombinuar për produkte të tilla.

2. Fortësia aktuale alkoolike për vëllim të pijeve alkoolike që përmbajnë mbi 1,2% të vëllimit alkool, të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 1 të këtij neni, deklarohen në përputhje me shtojcën XII bashkëlidhur këtij vendimi.

SEKSIONI 3

DEKLARATA E VLERAVE USHQIMORE

Neni 29

Marrëdhënia me legjislacione të tjera

1. Ky nen nuk zbatohet për produktet ushqimore që mbulohen nga fusha e zbatimit të legjislacionit të mëposhtëm:

- a) Urdhri nr. 216, datë 23.5.2008, i ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, “Mbi miratimin e rregullores “Për ushqimet shitesë””;
- b) Urdhri nr. 266, datë 29.8.2011, i ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, “Për miratimin e rregullores “Mbi shfrytëzimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale””.

2. Ky seksion zbatohet pa rënë ndesh me urdhrin nr. 211, datë 29.6.2011, të ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, “Mbi miratimin e rregullores “Mbi produktet ushqimore për përdorime të veçanta ushqimore””.

Neni 30

Përmbajtja e vlerave ushqyese

1. Deklarata e detyrueshme e vlerave ushqyese përfshin:

- a) Vlerën e energjisë;
- b) Sasinë e yndyrave, të yndyrave të ngopura, karbohidrateve, sheqernave, proteinave dhe kripës.

Sipas rastit, shumë pranë deklaratës së vlerave ushqyese mund të paraqitet një deklaratë që tregon se përmbajtja e kripës është ekskluzivisht për shkak të pranisë në mënyrë të natyrshme të natriumit.

2. Përmbajtja e deklaratës së detyrueshme të vlerave ushqyese, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, mund të plotësohet me deklarinimin e sasive të një ose më shumë treguesve, si më poshtë vijon:

- a) Me një lidhje të pangopur;
- b) Me shumë lidhje të pangopura;
- c) Poliolet;
- ç) Niseshte;
- d) Fibra;

dh) Mineralet apo vitaminat e renditura në pikën 1, të pjesës A, të shtojcës XIII dhe të pranishme në sasi të konsiderueshme, siç përcaktohet në pikën 2, të pjesës A, të shtojcës XIII.

3. Kur etiketimi i produktit ushqimor të paraambulazhuar parashikon deklaratën e detyrueshme të vlerave ushqyese të përmendura në pikën 1, informacioni i mëposhtëm mund të përsëritet, në:

- a) Vlerën e energjisë;
- b) Vlerën e energjisë, së bashku me sasinë e yndyrave, të yndyrave të ngopura, sheqernave dhe kripës.

4. Në përjashtim nga pika 1, e nenit 36, kur etiketimi i produkteve të përmendura në pikën 4, të nenit 16, paraqet një deklaratë të vlerave ushqyese, përmbajtja e deklaratës mund të kufizohet vetëm në vlerat e energjisë.

5. Pa rënë ndesh me nenin 40 dhe në përjashtim nga pika 1, e nenit 36, kur etiketimi i produkteve të përmendura në pikën 1, të nenit 40, paraqet një deklaratë të vlerave ushqyese, përmbajtja e deklaratës mund të kufizohet, vetëm në:

- a) Vlerën e energjisë;
- b) Vlerën e energjisë, së bashku me sasinë e yndyrave, të yndyrave të ngopura, sheqernave dhe kripës.

Neni 31

Llogaritja e vlerës së energjisë

1. Vlera e energjisë llogaritet me anë të faktorëve të konvertimit të dhëna në shtojcën XIV, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlera e energjisë dhe sasia e vlerave ushqyese të cituara në pikat 1 deri në 5, të nenit 30, duhet të jenë ato të produktit që shitet. Informacioni mund të lidhet me produktin pas përgatitjes, me kusht që të jepen udhëzime të mjaftueshme, të detajuara, për përgatitjen dhe që informacioni të lidhet me produktin ushqimor që përgatitet për konsum.

3. Vlerat e deklaruara, sipas rasteve individuale, janë vlerat mesatare të bazuara në:

- a) Analizën e prodhuesit të produktit ushqimor;
- b) Një llogaritje nga vlerat mesatare të njohura ose aktuale të përbërësve të përdorur;
- c) Një llogaritje nga të dhëna të përcaktuara dhe të pranuar përgjithësisht.

Neni 32

Shprehja për 100 g ose për 100 ml

1. Vlera e energjisë dhe sasia e vlerave ushqyese të cituara në pikat 1 deri në 5, të nenit 30, shprehet për 100 g ose për 100 ml, me anë të njërive të matjes, të dhëna në shtojcën XV bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Deklarata për vitaminat dhe mineralet, përveç formës së shprehjes së përmendur në pikën 1 të këtij neni, shprehet si përqindje e sasive referencë të konsumit, të përcaktuara në pikën 1, të pjesës A, të shtojcës XIII, për 100 g ose për 100 ml.

3. Përveç formës së shprehjes të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, vlera e energjisë dhe sasi të vlerave ushqyese të përcaktuara në pikat 1, 3, 4 e 5, të nenit 30, mund të shprehen, sipas rastit, si përqindje e sasive referencë të konsumit, të përcaktuara në pjesën B, të shtojcës XIII, për 100 g ose për 100 ml.

4. Kur informacioni paraqitet në përputhje me pikën 3 të këtij neni, shumë pranë tij paraqitet deklarata shtesë: “Sasia referencë e konsumit mesatar për një të rritur (8400 kJ/2000 kcal)”.

Neni 33

Shprehja për racion ose për njësi konsumi

1. Në rastet e mëposhtme, vlera e energjisë dhe sasi të vlerave ushqyese të cituara në pikat 1 deri në 5, të nenit 30, mund të shprehen për racion dhe/ose për njësi konsumi lehtësisht të identifikueshme nga konsumatori, me kusht që sasia e racionit ose e njësisë së përdorur të shënohet në etiketë dhe që numri i racioneve ose i njërive në paketim të deklarohet:

- a) Përveç formës së shprehjes për 100 g ose për 100 ml, të cituar në pikën 1, të nenit 32;

b) Përveç formës së shprehjes për 100 g ose për 100 ml të cituar në pikën 2, të nenit 32, për sasi të vitaminave dhe mineraleve;

c) Përveç ose në vend të formës së shprehjes për 100 g ose për 100 ml, të cituar në pikën 3, të nenit 32.

2. Në përjashtim nga pika 1, e nenit 32, në rastin e cituar në shkronjën “b”, të pikës 3, të nenit 30, sasia e vlerave ushqyese dhe/ose përqindja e sasive referencë të konsumit, të përcaktuara në pjesën B, të shtojcës XIII, mund të shprehen vetëm për racion ose për njësi konsumi.

Kur sasi të vlerave ushqyese shprehen vetëm për racion ose për njësi konsumi, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, vlera e energjisë shprehet për 100 g ose për 100 ml për racion ose për njësi konsumi.

3. Në përjashtim nga pika 1, e nenit 32, në rastet e cituara në pikën 5, të nenit 30, vlera e energjisë dhe sasia e vlerave ushqyese dhe/ose përqindja e sasive referencë të konsumit, të përcaktuara në pjesën B, të shtojcës XIII, mund të shprehen vetëm për racion ose për njësi konsumi.

4. Racioni ose njësia e përdorur vendosen pranë deklaratës së vlerave ushqyese.

Neni 34

Paraqitja e vlerës së energjisë

1. Të dhënat e përmendura në pikat 1 e 2, të nenit 30, përfshihen në të njëjtën fushëpamje. Ato paraqiten së bashku, në format të qartë dhe, sipas rastit, në rendin e prezantimit të parashikuar në shtojcën XV, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të dhënat e përmendura në pikat 1 e 2, të nenit 30, paraqiten, nëse ka hapësirë, në një tabelë, me numra të harmonizuar. Kur nuk ka hapësirë të mjaftueshme, deklarata shfaqet në format linear.

3. Të dhënat e përmendura në pikën 3, të nenit 30, paraqiten:

a) Në fushëpamjen kryesore;

b) Me madhësi shkrimi në përputhje me pikën 2, të nenit 13.

4. Të dhënat e përmendura në pikat 3, 4 e 5, të nenit 30, mund të paraqiten në format të ndryshëm nga ai i specifikuar në pikën 2, të këtij neni.

5. Në rastet kur vlera e energjisë ose sasia e vlerave ushqyese në një produkt është e papërfillshme, informacioni për këto elemente mund të zëvendësohet me deklaratën: “Përmban sasi të papërfillshme të ...” dhe të paraqitet pranë deklaratës së vlerave ushqyese, kur është e pranishme.

Neni 35

Format shtesë të shprehjes dhe të paraqitjes

1. Përveç formave të shprehjes të cituara në nenet 32, pikat 1 e 3, dhe 33, si dhe paraqitjeve të cituara në pikën 2, të nenit 34, vlera e energjisë dhe sasia e vlerave ushqyese të cituara në pikat 1 deri në 5, të nenit 30, mund të jepen me anë të formave të tjera të shprehjes dhe/ose të paraqiten me forma grafike ose simbole, përveç fjalëve apo numrave, me kusht që të plotësohen kërkesat e mëposhtme:

a) Të bazohen në kërkime të sigurta e shkencërisht të vlefshme për konsumatorin dhe të mos e çorientojnë atë, siç përmendet në nenin 7, të këtij vendimi;

b) Zhvillimi i tyre të jetë rezultat i konsultimit me një grup më të madh palësh të interesuara;

c) Të synojnë të lehtësojnë kuptimin nga konsumatori të kontributit ose të rëndësisë së ushqimit në raport me energjinë dhe vlerat ushqyese në një dietë;

ç) Të mbështeten nga prova të vlefshme shkencërisht të kuptimit të këtyre formave të shprehjes ose të paraqitjes nga niveli mesatar i konsumatorëve;

d) Në rastin e formave të tjera të shprehjes, ato bazohen në sasi referencë të konsumit të harmonizuara, të përcaktuara në shtojcën XIII ose, në mungesë të tyre, në këshillim shkencor të pranuar gjerësisht për sasi referencë të konsumit për energjinë ose vlerat ushqyese;

dh) Janë objektive dhe jodiskriminuese;

e) Zbatimi i tyre nuk krijon pengesa për lëvizjen e lirë të mallrave.

2. Operatorët e biznesit ushqimor mund të përdorin një ose më shumë nga format shtesë të shprehjes ose të paraqitjes së deklaratës ushqimore, të cilat ata i konsiderojnë si përmbushjen më të mirë të kërkesave të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “e”, të pikës 1, të këtij neni. Operatorët e biznesit i paraqesin ministrisë të dhëna të detajuara të këtyre formave shtesë të shprehjes dhe të paraqitjes, si dhe argumentimet përkatëse, në lidhje me përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “e”, të pikës 1. Në këto raste mund të kërkohet informacion për ndërprerjen e përdorimit të këtyre formave shtesë të shprehjes ose të paraqitjes së deklaratës së vlerave ushqimore.

3. AKU-ja monitoron format shtesë të shprehjes ose të paraqitjes së deklaratës së vlerave ushqyese që janë të pranishme në tregun shqiptar.

4. Informacioni që lidhet me përdorimin e formave shtesë të shprehjes ose të paraqitjes së deklaratës së vlerave ushqyese shkëmbehet ndërmjet ministrisë, AKU-së, ISUV-it dhe palëve të interesuara për këto çështje.

KREU V INFORMACIONI USHQIMOR VULLNETAR

Neni 36

Kërkesat e zbatueshme

1. Kur informacioni ushqimor i përmendur në nenet 9 e 10 jepet në mënyrë vullnetare, ky informacion duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në seksionet 2 dhe 3, të kreut IV.

2. Informacion ushqimor i dhënë në mënyrë vullnetare duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) Të orientojë në mënyrë të drejtë konsumatorin, siç përmendet në nenin 7;

b) Të jetë i qartë dhe nuk duhet të ketë dy kuptime për konsumatorin;

c) Sipas rastit, të bazohet në të dhënat shkencore përkatëse.

3. Kërkesat e cituara në pikën 2 të këtij neni, për informacionin ushqimor vullnetar, përfshijnë:

a) Informacion për praninë e mundshme dhe të paqëllimshme të substancave ose të produkteve që shkaktojnë alergji ose intoleranca në produktin ushqimor;

b) Informacion për përshtatshmërinë e një produkti ushqimor për vegjetarianët dhe vegjetarianët e plotë;

c) Deklarimin e sasive referencë të konsumit për grupe specifike të konsumatorëve, përveç sasive referencë të konsumit, të përcaktuara në shtojcën XIII bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 37

Paraqitja e informacionit vullnetar

Informacioni ushqimor vullnetar nuk duhet të vendoset, nëse dëmton hapësirën e disponueshme për informacionin ushqimor të detyrueshëm.

Neni 38

Pije alkoolike

Përbërësit e përcaktuar në pikën 4, të nenit 16 dhe të renditur në shtojcën XII të tregohen në etiketë në rastet kur janë të pranishëm në pijet që përmbajnë më shumë se 1.2% të volumit alkool. Ky deklaram duhet të përmbajë fjalën “përfshin” të ndjekur nga emri i përbërësve të sipërpërmendur. Tregimi (deklarimi) nuk është i nevojshëm në rastin kur përbërësi përfshihet me emrin e tij specifik në listën e përbërësve ose me emrin me të cilin pija shitet.

Neni 39

Shprehja e sasisë neto

1. Sasia neto e ushqimeve të ambalazuara paraprakisht duhet të shprehet:

- në njësi volumore, si në rastin e lëngjeve;

- në njësi mase në rastin e produkteve të tjera,

duke përdorur litrin, centilitrin, mililitrin, gramën ose kilogramin, sipas rastit.

a) Kur deklarimi i një tipi të caktuar sasië (p.sh., sasia nominale, sasia minimale, sasia mesatare) kërkohet nga një legjislacion tjetër, kjo sasi do të nënkuptohet si sasia neto në kuadrin e këtij vendimi;

b) Kur një njësi e ambalazhuar paraprakisht konsiston në dy ose më shumë njësi individuale të ambalazuara paraprakisht që përmbajnë të njëjtën sasi të të njëjtit produkt, sasia neto do të tregohet duke përmendur sasinë neto që është në çdo paketë individuale dhe numrin total të këtyre paketave. Megjithatë deklarimi i këtyre veçantive nuk do të jetë i detyrueshëm në rast se numri total i paketave individuale mund të shihet qartë dhe mund të numërohet lehtë nga jashtë dhe kur të paktën një deklaram i sasisë neto të ndodhur në çdo paketë individuale mund të shihet nga jashtë;

c) Kur një njësi e ambalazhuar paraprakisht konsiston në dy ose më shumë paketa individuale të cilat nuk janë njësi shitjeje, sasia neto do të jepet duke deklaruar sasinë totale neto dhe numrin total të paketave individuale.

2. Produktet ushqimore që normalisht shiten me numër nuk kërkojnë ndonjë deklaram të sasisë neto, kur numri i njërive shihet qartë dhe numërohet lehtë nga jashtë ose, nëse kjo nuk është e mundur, të

deklarohet në etiketë.

3. Kur një ushqim i ngurtë prezantohet në një mjedis të lëngët, në etiketë duhet të deklarohet pesha neto pas kullimit të produktit ushqimor. Për qëllim të këtij paragrafi, “mjedis i lëngët” do të nënkuptojë të gjitha produktet e mëposhtme, mundësisht në përzierje dhe, gjithashtu, të ngrira ose me ngrirje të shpejtë, me kusht që lëngu të jetë një shtesë ndaj elementeve kryesore të kësaj përgatitjeje dhe si i tillë të mos përbëjë një faktor përcaktues për blerjen: ujë, solucione ujore kripërash, shëllirë, solucione ujore të acideve ushqimore, uthull, solucione acide të sheqernave, solucione ujore të substancave të tjera ëmbëlsuese, lëngje frutash ose perimesh në rast të frutave ose perimeve.

4. Nuk do të jetë e detyrueshme të deklarohet sasia neto në rast të produkteve ushqimore:

a) Që janë subjekt i humbjeve të konsiderueshme në volum ose masë dhe që shiten në numër ose peshohen në prani të blerësit;

b) Sasia neto e të cilave është më pak se 5 g ose 5 ml; ky kusht nuk do të aplikohet për erëzat dhe bimët medicinale.

Neni 40

Produktet ushqimore që nuk janë të paraambalazuara

Në rastet kur produktet ushqimore ofrohen për shitje te konsumatori i fundit ose te shërbimi *catering* pa ambalazhim paraprak ose kur produktet ushqimore paketohen në ambientet e shitjes me kërkesë të konsumatorit apo ambalazhohen paraprakisht për shitje direkte:

a) Paraqitja e veçorive të specifikuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 9, është e detyrueshme;

b) Paraqitja e veçorive të tjera të cituara në nenet 9 dhe 10 nuk është e detyrueshme.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 41

1. Shkeljet e dispozitave të këtij vendimi do të trajtohen sipas përcaktimeve të nenit 68, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar.

2. Stoqet e produkteve ushqimore që nuk përpunohen me kërkesat e këtij vendimi dhe që janë vendosur në treg deri në hyrjen në fuqi të tij, mund të vazhdojnë të shiten, por jo më vonë se 1 (një) vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Pikat 2, shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “f”, “g” dhe 3, të neni 26, të këtij vendimi, zbatohen drejtpërdrejt me anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

4. Vendimi nr. 1344, datë 10.10.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave “Për etiketimin e produkteve ushqimore””, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 2 vite pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi

SHTOJCA I

PËRKUFIZIME SPECIFIKE

Siç përmendet në nenin 2, pika 4:

1. “Deklaratë e vlerave ushqyese” ose “etiketim ushqimor” është informacioni ku shprehet:

a) Vlera e energjisë; ose

b) Vlera e energjisë dhe vetëm një ose më shumë nga vlerat e mëposhtme ushqyese:

- yndyra (të ngopura, me një lidhje të pangopur, me shumë lidhje të pangopura);

- karbohidrate (sheqerna, polirole, niseshte);

- kripa;

- fibra;

- proteina;

- çdo mineral apo vitaminë i renditur në pikën 1 të pjesës A, të shtojcës XIII dhe i pranishëm në sasi të konsiderueshme siç përcaktohet në pikën 2 të pjesës A, të shtojcës XIII.

2. “Yndyrna” janë lipidet totale, duk përfshirë fosfolipidet.

3. “Yndyrna të ngopura” janë acidet yndyrore pa lidhje dyfishe.
4. “Yndyrna të pangopura” janë acidet yndyrore me të paktën një lidhje dyfishe karbon-karbon të pakonjuguar në konfigurimin trans (përkatësisht me ndërprerje në të paktën një grup metilen).
5. “Yndyrna me një lidhje të pangopur” janë acidet yndyrore me një lidhje dyfishe cis.
6. “Yndyrna me shumë lidhje të pangopura” acidet yndyrore me dy ose më shumë cis, cis-metilene me ndërprerje të lidhjeve dyfishe.
7. “Karbohidrat” është çdo karbohidrat, i cili është i metabolizuar te njeriu, përfshirë poliolet.
8. “Sheqerna” janë të gjitha monosakaridet dhe disakaridet të pranishme në produktet ushqimore, me përjashtim të polioleve.
9. “Polirole” janë alkoole të përmbajnë më shumë se dy grupe hidroksil.
10. “Proteina” është përmbajtja e proteinave e llogaritur duke përdorur formulën: proteinë = azoti total Kjeldahl \times 6,25.
11. “Kripë” është përmbajtja ekuivalente e kripës e llogaritur duke përdorur formulën: kripë = natrium \times 2,5.
12. “Fibra” janë polimere karbohidrati me tri ose më shumë njësi monomerike, të cilat nuk treten dhe as nuk thithen nga zorrët e holla të njeriut dhe u përkasin kategorive të mëposhtme:
 - polimere karbohidrati të ngrënshme që janë të pranishme në mënyrë të natyrshme në produkte ushqimore të konsumuara;
 - polimere karbohidrati të ngrënshme, të cilat janë përfutur nga materiali i parë ushqimor me anë të metodave fizike, enzimatike ose kimike dhe të cilat kanë një efekt fiziologjik dobiprurës të provuar nga provat shkencore të pranuar gjerësisht;
 - polimere karbohidrati sintetike të ngrënshme, të cilat kanë një efekt fiziologjik dobiprurës të provuar nga provat shkencore të pranuar gjerësisht.
13. “Vlerë mesatare” është vlera që paraqet më mirë sasinë e vlerës ushqyese, që përmban një produkt ushqimor dhe pasqyron ndryshimet për shkak të ndryshimit stinor, modelet e konsumit dhe faktorë të tjerë që mund të shkaktojnë ndryshimin e vlerës aktuale.

SHTOJCA II

SUBSTANCAT OSE PRODUKTET QË SHKAKTOJNË ALERGJI OSE INTOLERANCA

1. Drithërat me përmbajtje gluteni, përkatësisht: gruri, thekra, elbi, tërshëra ose linjat e tyre të hibridizuara dhe produktet e tyre, përveç:
 - a) Shurup glukozë me bazë gruri përfshirë dekstrozën^{2 (1)};
 - b) Maltodekstrinë me bazë gruri⁽¹⁾;
 - c) Shurupit glukozë me bazë elb;
 - d) Drithërave të përdorura për distilate alkoolike, përfshirë alkoolin etilik me origjinë bujqësore;
2. Krustacët dhe produktet e tyre;
3. Vezët dhe produktet e tyre;
4. Peshku dhe produktet e tij, përveç:
 - a) Xhelatinës së peshkut që përdoret si bartës për vitaminat ose për përgatitjet e karotinoideve;
 - b) Xhelatinës së peshkut ose Isinglass që përdoret si agjent finiteure në birra dhe verë;
5. Kikiriku dhe produktet e tij;
6. Soja dhe produktet e saj, përveç:
 - a) Vajit të rafinuar të sojës dhe yndyrat;
 - b) Tokoferoleve të përzier natyrale (E 306), tokoferolit D-alfa natyral, acetatit tokoferol D-alfa natyral dhe tokoferolit suksinat D-alfa natyral me origjinë soje;
 - c) Vajrave bimore të përfutur nga fitosteroleve dhe esteret e fitosteroleve me origjinë soje;
 - d) Ester stanolit bimor të prodhuar nga sterolet e vajit bimor me origjinë soje;
7. Qumështi dhe produktet e qumështit (duke përfshirë laktozën), përveç:
 - a) Hirrës së përdorur për distilate alkoolike, përfshirë alkoolin etilik me origjinë bujqësore;
 - b) Acidit laktik;
8. Frutat e thata, përkatësisht: bajamet (*Amygdalus communis* L.), lajthitë (*Corylus avellana*), arrat e buta (*Juglans regia*), arrat e shqemes (*Anacardium occidentale*), arrat hikore (*Carya illinoensis* (Ēangenh.) K.

^{2 (1)} dhe produktet e tyre, për aq sa procesi që ata kanë pësuar nuk ka mundësi për të rritur nivelin e allergjenve vlerësuar nga AKU-ja për produktin përkatës nga i cili ata origjinojnë.

Koch), arrat braziliane (*Bertholletia excelsa*), fistikët (*Pistacia vera*), arrat makademia ose Kuinslend (*Macadamia ternifolia*) dhe produktet që vijnë prej tyre, përveç frutave të thata të përdorura për distilate alkoolike, përfshirë alkoolin etilik me origjinë bujqësore;

9. Selinoja dhe produktet e saj;
10. Sinapi dhe produktet e tij;
11. Farat e susamit dhe produktet e tyre;
12. Dyoksidi i sulfurit dhe sulfitet të përqendruara më shumë se 10 mg/kg ose 10 mg/l të shprehura si total i SO₂, të cilat duhet të llogariten për produktet të propozuara si të gatshme për konsum ose të riformuluara sipas udhëzimeve të prodhuesve;
13. Lupina dhe produktet e saj;
14. Molusqet dhe produktet e tyre;

SHTOJCA III

PRODUKTET USHQIMORE PËR TË CILAT ETIKETIMI DUHET TË PËRFSHIJË NJË OSE MË SHUMË VEÇORI SHITESË


LLOJET OSE KATEGORITË E PRODUKTEVE USHQIMORE	VEÇORITË
1. Produkte ushqimore të paketuara me gaze të caktuara	
1.1 Produktet ushqimore, jetëgjatësia e të cilave është shtyrë nga mënyrat e paketimit me gaze, të autorizuara sipas udhëzimit nr. 18, datë 17.11.2010, "Për aditivët ushqimorë të përdorur në produktet ushqimore".	"Paketuar në ambient mbrojtës".
2. Produkte ushqimore që përmbajnë ëmbëlsues	
2.1 Produktet ushqimore që përmbajnë një ëmbëlsues ose disa ëmbëlsues, të autorizuar sipas udhëzimit nr. 18, datë 17.11.2010 "Për aditivët ushqimorë të përdorur në produktet ushqimore".	"Me ëmbëlsues", kjo deklaratë shoqëron emrin e produktit ushqimor.
2.2 Produktet ushqimore që përmbajnë sheqer ose sheqerna shtesë dhe një ëmbëlsues ose disa ëmbëlsues, të autorizuar sipas udhëzimit nr. 18, datë 17.11.2010, "Për aditivët ushqimorë të përdorur në produktet ushqimore".	"Me sheqerna dhe ëmbëlsues", kjo deklaratë shoqëron emrin e produktit ushqimor.
2.3 Produktet ushqimore që përmbajnë aspartam/kripë aspartam-acesulfami, të autorizuar sipas udhëzimit nr. 18, datë 17.11.2010, "Për aditivët ushqimorë të përdorur në produktet ushqimore".	"Përmban aspartam (burim të fenilalaninës)" shfaqet në etiketë në rastet kur aspartami/kripa e aspartam-acesulfamit është përcaktuar në listën e përbërësve vetëm duke iu referuar numrit E. "Përmban burim fenilalanine" shfaqet në etiketë në rastet kur aspartami/kripa e aspartam-acesulfamit është përcaktuar në listën e përbërësve me emrin e saj specifik.
2.4 Produkte ushqimore që përmbajnë më shumë se 10% poliole shtesë, të autorizuara sipas udhëzimit nr. 18, datë 17.11.2010, "Për aditivët ushqimorë të përdorur në produktet ushqimore".	"Përdorimi i tepërt mund të japë efekte laksative".
3. Produktet ushqimore që përmbajnë acid glicirrhizinik ose kripë amoniake të tij	
3.1 Ëmbëlsirat ose pijet që përmbajnë acid glicirrhizinik ose kripë amoniake të tij, si pasojë e shtimit të substancave si të tilla ose të bimës jamballi "Glycyrrhiza glabra" në përqendrim prej 100 mg/kg ose 10 mg/l ose më shumë.	"Përmban jamballi" shtohet menjëherë pas listës së përbërësve, përveç nëse termi "jamballi" është përfshirë tashmë në listën e përbërësve ose në emrin e produktit ushqimor. Në mungesë të listës së përbërësve, deklarata shoqëron emrin e produktit ushqimor.
3.2 Ëmbëlsirat që përmbajnë acid glicirrhizinik ose kripë amoniake të tij, si pasojë e shtimit të substancave si të tilla ose të bimës jamballi	"Përmban jamballi – njerëzit që vuajnë nga hipertensioni duhet të shmangin konsumin e tepërt" shtohet menjëherë pas listës së përbërësve. Në mungesë të listës së përbërësve, deklarata shoqëron

<p>“Glycyrrhiza glabra” në përqendrim prej 4 g/kg ose më shumë.</p>	<p>emrin e produktit ushqimor.</p>
<p>3.3 Pijet që përmbajnë acid glicirrhizinik ose kripë amoniake të tij si pasojë e shtimit të substancave si të tilla ose të bimës jamballi “Glycyrrhiza glabra” në përqendrim prej 50 mg/l ose më shumë ose prej 300 mg/l ose më shumë në rastin e pijeve që përmbajnë më shumë se 1,2% të vëllimit me alkool ⁽¹⁾.</p>	<p>“Përmban jamballi – njerëzit që vuajnë nga hipertensioni duhet të shmangin konsumin e tepërt” shtohet menjëherë pas listës së përbërësve. Në mungesë të listës së përbërësve, deklarata shoqëron emrin e produktit ushqimor.</p>
<p>4. Pijet me përmbajtje të lartë kafeine ose produktet ushqimore me kafeinë shtesë</p>	
<p>4.1 Pijet, me përjashtim të atyre me bazë kafeje, çaji ose ekstrakt kafeje ose çaji, kur emri i produktit ushqimor përmban termin “kafe” ose “çaj” :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të cilat janë destinuar për konsum, pa modifikim dhe përmbajnë kafeinë, nga çfarëdo burimi, në një proporcion që tejkalon 150 mg/l; ose - të cilat janë në formë të përqendruar ose të thatë dhe pas riformulimit përmbajnë kafeinë, nga çfarëdo burimi, në një proporcion që tejkalon 150 mg/l. 	<p>“Përmbajtje e lartë kafeine. Nuk rekomandohet për fëmijë, gra shtatzëna ose gra që ushqejnë fëmijë me gj” në të njëjtën fushë pamjeje të emrit të pijes, të ndjekur nga një referencë në kllapa dhe në përputhje me nenin 13, pika 1 e kësaj VKM-je, për përmbajtjen e kafeinës të shprehur në mg për 100 ml.</p>
<p>4.2 Produktet ushqimore përveç pijeve, ku kafeina shtohet me qëllim fiziologjik.</p>	<p>“Përmban kafeinë. Nuk rekomandohet për fëmijë ose gra shtatzëna” në të njëjtën fushë pamjeje të emrit të produktit ushqimor, të ndjekur nga një referencë në kllapa dhe në përputhje me nenin 13, pika 1 e kësaj VKM-je, për përmbajtjen e kafeinës, të shprehur në mg për 100 ml. Në rastin e suplementeve ushqimore, përmbajtja e kafeinës shprehet me porcion siç rekomandohet për konsum ditor në etiketë.</p>
<p>5. Produktet ushqimore me fitosterole të shtuara, estere të fitosteroleve, fitostanole ose estere fitostanolesh</p>	
<p>5.1 Produktet ushqimore ose të përbërësit ushqimor me fitosterole të shtuara, estere të fitosteroleve, fitostanole ose estere fitostanolesh.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. “Me sterole të shtuara bimore” ose “me stanole të shtuara bimore” në të njëjtën fushë pamjeje të emrit të produktit ushqimor; 2. Sasinë e përmbajtjes së fitosteroleve të shtuara, estereve fitosterole, fitostanoleve ose estereve të fitostanoleve (e shprehur në % ose në “g” të steroleve të lira bimore/stanole bimore për 100 g ose për 100 ml produkt ushqimor) do të vendoset në listën e përbërësve; 3. Një deklaratë, që produkti ushqimor është i destinuar për njerëz që duan të ulin nivelin e kolesterolit në gjak; 4. Një deklaratë që pacientët me mjekim për uljen e nivelit të kolesterolit duhet ta konsumojnë produktin nën mbikëqyrjen e mjekut; 5. Një deklaratë lehtësisht të dukshme, që produkti mund të mos jetë i përshtatshëm nga ana ushqimore për gra shtatzëna ose gra që ushqejnë fëmijë me gjë ose për fëmijë nën 5 vjeç; 6. Këshillim që produkti ushqimor duhet të përdoret si pjesë e një diete të balancuar dhe të ndryshueshme, përfshirë konsum të rregullt të frutave dhe perimeve për të ndihmuar mbajtjen e niveleve të përcaktuara të karotenës; 7. Në të njëjtën fushë pamjeje me deklaratën e nevojshme sipas pikës 3 më sipër, një deklaratë që konsumimi i më shumë se 3 g/ditë i steroleve të shtuara bimore/stanoleve bimore duhet të shmanget;

	8. Një përkufizim të porcionit të produktit ushqimor ose të përbërësve ushqimorë të përcaktuar (preferohen në g ose ml) me sasinë e steroleve bimore/stanoleve bimore të përfshirë në çdo porcion.
6. Mish i ngrirë, përgatitje mishi të ngrirë dhe produkte peshkimi të papërpunuara e të ngrira	
6.1 Mishi i ngrirë, përgatitjet e mishit të ngrirë dhe produktet e peshkimit të papërpunuara e të ngrira.	Datën e ngrirjes ose datën e ngrirjes së parë në rastet kur produkti është ngrirë më shumë se një herë, në përputhje me pikën 3 të shtojcës X.
⁽¹⁾ Niveli do të aplikohet për produktet e propozuara gati për konsum ose të riformuara në përputhje me instruksionet e prodhuesit.	

SHTOJCA IV
PËRKUFIZIMI I LARTËSISË - x

LARTËSIA - x



LEGJENDA

1	Vija ose kufiri i sipërm i shkronjave
2	Lartësia e shkronjave të mëdha
3	Lartësia e shkronjave të vogla
4	Vija bazë e shkronjave
5	Vija ose kufiri i poshtëm i shkronjave
6	Lartësia x
7	Përmasa e shkronjave

SHTOJCA V

PRODUKTET USHQIMORE TË CILAT PËRJASHTOHEN NGA KËRKESA E DEKLARATËS
SË DETYRUESHME TË VLERAVE USHQIMORE

1. Produktet e papërpunuara që përmbajnë një përbërës të vetëm ose kategori përbërësish;
2. Produktet e përpunuara të cilat i janë nënshtruar vetëm maturimit dhe që përmbajnë një përbërës të vetëm ose kategori përbërësish;
3. Ujërat e destinuar për konsum njerëzor, përfshirë ato ku përbërësit e vetëm shtesë janë dyoksidi i karbonit dhe/ose substancat aromatizuese;
4. Barërat, erëzat ose përzierjet e tyre;
5. Kripa dhe zëvendësuesit e kripës;
6. Ëmbëlsuesit artificialë;
7. Ekstraktet e kafes dhe çikores, kokrrat e kafes të plota ose të shtypura dhe të plota ose kokrrat e

kafes të dekafeinizuara dhe të bluara;

8. Infusionet bimore dhe të frutave, çaji, çaji i dekafeinizuar, çaji i çastit ose i tretshëm ose ekstrakti i çajit, çaji i dekafeinizuar, i çastit ose i tretshëm, që nuk përmbajnë përbërës të tjerë shtesë, përveç substancave aromatizuese, të cilat nuk modifikojnë vlerën ushqyese të çajit;

9. Uthullat e fermentuara dhe zëvendësuesit e uthullës, përfshirë ato ku të vetmit përbërës të shtuar janë substancat aromatizuese;

10. Substancat aromatizuese;

11. Aditivët ushqimorë;

12. Lëndët ndihmëse të përpunimit;

13. Enzimata ushqimore;

14. Xhelatina;

15. Mjedisi përbërës i reçelrave;

16. Majaja;

17. Çamçakëzi;

18. Produktet ushqimore në paketim ose kontejnerë, sipërfaqja më e madhe e të cilave është më pak se 25 cm²;

19. Produkte ushqimore, përfshirë produktet ushqimore të prodhuara me dorë, të ofruara drejtpërdrejt në sasi të vogla nga prodhuesi te konsumatori i fundit ose te qendrat vendore të shitjeve me pakicë të cilat ua ofrojnë drejtpërdrejt konsumatorëve të fundit.

SHTOJCA VI

EMRI I PRODUKTTIT USHQIMOR DHE VEÇORITË SPECIFIKE SHOQËRUESE

PJESA A

VEÇORITË E DETYRUESHME SHOQËRUESE TË EMRIT TË PRODUKTTIT USHQIMOR

1. Emri i produktit ushqimor përfshin ose shoqërohet nga veçoritë e tilla, si: gjendja fizike e produktit ushqimor ose trajtimi specifik që ka pësuar (për shembull, pluhur, i ngrirë, ngrirje e thellë, i përqendruar, i tymosur) në të gjitha ato raste kur mosdhënia e këtij informacioni mund të jetë çorientues për blerësin.

2. Në rastin e produkteve ushqimore që janë ngrirë para shitjes dhe të cilat janë shitur të shkrija, emri i produktit ushqimor shoqërohet nga emërtimi “i shkrië”.

Kjo kërkesë nuk zbatohet për:

a) Përbërësit në produktin përfundimtar;

b) Produktet ushqimore për të cilat ngrirja është një hap teknologjikisht i nevojshëm gjatë procesit të prodhimit;

c) Produktet ushqimore për të cilat shkrirja nuk ka ndikim negativ në sigurinë ose cilësinë e ushqimit.

Kjo pikë zbatohet pa cenuar pikën 1.

3. Produktet ushqimore të trajtuara me rrezatim jonizues mbajnë një nga deklaratimet e mëposhtme:

“I parrezatuar” ose “trajtuar me rrezatim jonizues” dhe deklarime të tjera të shprehura në udhëzimin nr. 4, datë 14.5.2014, “Mbi produktet ushqimore dhe ingredientët ushqimorë të trajtuar me rrezatim jonizues”.

4. Në rastin e produkteve ushqimore në të cilat një komponent ose përbërës që konsumatorët presin që të përdoret normalisht ose që të jetë i pranishëm në mënyrë natyrale është zëvendësuar me një komponent ose përbërës tjetër, përveç listës së përbërësve, etiketimi do të mbajë një deklaram të qartë të komponentit ose të përbërësit që është përdorur për zëvendësim të pjesshëm ose të plotë:

a) Shumë pranë emrit të produktit; dhe

b) Duke përdorur një madhësi shkronjash me lartësi x të paktën 75% të lartësisë së produktit dhe jo më të vogël se madhësia minimale e shkronjave të kërkuara në nenin 13, pika 2, të kësaj rregulloreje.

5. Në rastin e produkteve të mishit, përgatitjeve të mishit dhe produkteve të peshkimit që përmbajnë proteina shtesë si të tilla, përfshirë proteinat e hidrolizuara, me origjinë të ndryshme shtazore, emri i produktit ushqimor mban një deklaram të pranisë së këtyre proteinave dhe të origjinës së tyre.

6. Në rastin e produkteve të mishit, përgatitjeve të mishit, të cilat kanë pamjen e një të prere, cope, fete, porcioni ose karkase mishi, emri i produktit ushqimor përfshin një deklaram të pranisë së ujit të shtuar, nëse uji i shtuar përbën më shumë se 5% të peshës së produktit përfundimtar. Të njëjtat rregulla zbatohen në rastin e produkteve të peshkimit dhe të produkteve të përgatitura të peshkimit, të cilat kanë pamjen e një të prere, cope, fete, porcioni, filetoje ose të një produkti të plotë peshkimi.

7. Produktet e mishit, përgatitjet e mishit dhe produktet e peshkimit, të cilat mund të japin përshtypjen

se përbëhen nga një copë e tërë mishi ose peshku, por që faktikisht përbëhen nga copa të ndryshme të kombinuara së bashku me përbërës të tjerë, përfshirë aditivët ushqimorë dhe enzimën ushqimore:

- Bullgarisht: *формовано месо* dhe *формована риба*;
 Spanjisht: *combinado de piezas de carne* dhe *combinado de piezas de pescado*;
 Çekisht: *ze spojovaných kousků masa* dhe *ze spojovaných kousků rybího masa*;
 Danisht: *Sammensat af stykker af kød* dhe *Sammensat af stykker af fisk*;
 Gjermanisht: *aus Fleischstücken zusammengefügt* dhe *aus Fischstücken zusammengefügt*;
 Estonisht: *liidetud liha* dhe *liidetud kala*;
 Greqisht: *μορφοποιημένο κρέας* dhe *μορφοποιημένο ψάρι*;
 Anglisht: *formed meat* dhe *formed fish*;
 Frëngjisht: *viande reconstituée* dhe *poisson reconstitué*;
 Irlandisht: *píosáí feola ceangailte* dhe *píosáí éisc ceangailte*;
 Italisht: *carne ricompasta* dhe *pesce ricomposto*;
 Letonisht: *formēta gaļa* dhe *formēta zivs*;
 Lituanisht: *sudarytas (-a) iš mėsos gabalų* dhe *sudarytas (-a) iš žuvių gabalų*;
 Hungarisht: *darabokból újraformázott hús* dhe *darabokból újraformázott hal*;
 Maltisht: *laham rikostitëit* dhe *hut rikostitëit*;
 Holandisht: *samengesteld uit stukjes vlees* dhe *samengesteld uit stukjes vis*;
 Polonisht: *z połączonych kałkówek mięsa* dhe *z połączonych kałkówek ryby*;
 Portugalisht: *carne reconstituída* dhe *peixe reconstituído*;
 Rumanisht: *carne formată* dhe *carne de pește formată*;
 Sllovakisht: *spájané alebo formované mäso* dhe *spájané alebo formované ryby*;
 Sllovenisht: *sestavljeno, iz koščkov oblikovano meso* dhe *sestavljeno, iz koščkov oblikovane ribe*;
 Finlandisht: *paloista yhdistetty liha* dhe *paloista yhdistetty kala*;
 Suedisht: *sammanfogade bitar av kött* dhe *sammanfogade bitar av fisk*.

PJESA B

KËRKESAT SPECIFIKE LIDHUR ME EMËRTIMIN “MISH I GRIRË”

1. Kriteret e përbërjes të kontrolluara në bazë të një mesatareje ditore:

	Përmbajtja e yndyrës	Raporti kolagjen/proteina të mishit
- Mish i grirë pa dhjamë	≤ 7%	≤ 12%
- Mish viçi në formë të pastër i grirë	≤ 20%	≤ 15%
- Mish i grirë që përmban mish derri	≤ 30%	≤ 18%
- Mish i grirë i llojeve të tjera	≤ 25%	≤ 15%

2. Përveç kërkesave të përcaktuara në kreun IV, të seksionit V, të shtojcës III të urdhrin nr. 10, datë 13.1.2010, “Mbi vlerësimin dhe kategorizimin e stabilimenteve të produkteve ushqimore me origjinë shtazore”, shprehjet e mëposhtme shfaqen në etiketë:

- “përqindja e përmbajtës së yndyrës nën ...”,
- “raporti i kolagjenit/i proteinave të mishit ...”,

3. Mund të lejohet vendosja në treg e mishit të grirë që nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 1 të kësaj pjese, sipas një marke kombëtare që të mos ngatërrohet me markat e parashikuara në nenin 5, pika 1, e urdhrin nr. 10, datë 13.1.2010, “Mbi vlerësimin dhe kategorizimin e stabilimenteve të produkteve ushqimore me origjinë shtazore”.

PJESA C

KËRKESAT SPECIFIKE LIDHUR ME EMËRTIMIN E LËKURËS SË SALLAMIT

Duhet të tregohen rastet kur lëkura e sallamit nuk është e konsumueshme.

SHTOJCA VII
DEKLARIMI DHE EMËRTIMI I PËRBËRËSVE

PJESA A
DISPOZITAT SPECIFIKE LIDHUR ME DEKLARIMIN E PËRBËRËSVE NË REND ZBRITËS
TË PESHËS

Kategoria e përbërësit	Dispozita për deklarimin e peshës
1. Uji i shtuar dhe produktet e avullueshme	Renditen sipas peshës së tyre në produktin përfundimtar. Sasia e ujit të shtuar si një përbërës në një produkt ushqimor llogaritet duke zbritur nga sasia totale e produktit përfundimtar sasinë totale të përbërësve të tjerë të përdorur. Kjo sasi nuk merret në konsideratë nëse nuk tejkalon 5% të peshës së produktit përfundimtar. Kjo shmangie nuk zbatohet për mishin, përgatitjet e mishit, produktet e papërpunuara të peshkimit dhe molusqet dykapakore të papërpunuara.
2. Përbërësit e përdorur në formë të përqendruar apo të dehidratuar dhe të riformuluar në kohën e prodhimit.	Mund të renditen sipas peshës, siç janë regjistruar përpara përqendrimit apo dehidratimit të tyre.
3. Përbërësit e përdorur në produktet ushqimore ,të përqendruar apo të dehidratuar, të cilët janë të destinuar të riformulohen nga shtesat me ujë.	Mund të renditen sipas proporcionit në produktin e riformuluar në rast se lista e përbërësve është shoqëruar nga një shprehje si “përbërësit e produktit të riformuluar” ose “përbërësit e produktit gati për t’u përdorur”.
4. Frutat, perimet apo kërpudhat, në rastin kur asnjëra prej tyre nuk mbizotëron në lidhje me peshën dhe të cilat janë përdorur në proporcione që kanë gjasa të ndryshojnë, të përdorura në një përzierje si përbërës të një produkti ushqimor.	Mund të grupohen së bashku në listën e përbërësve nën termin “frutë”, “perime” ose “kërpudha” të ndjekura nga fraza “në proporcione që ndryshojnë”, menjëherë të ndjekura nga lista e frutave, perimeve ose kërpudhave të pranishme. Në raste të tilla, përzierja përfshihet në listën e përbërësve në përputhje me nenin 18, pika 1, në bazë të peshës totale të frutave, perimeve dhe kërpudhave të pranishme.
5. Përzierjet e erëzave dhe bimëve, kur asnjëra nuk mbizotëron në mënyrë të veçantë në proporcion sipas peshës.	Mund të renditen në një rend tjetër me kusht që lista e përbërësve të shoqërohet nga një shprehje të tillë si “në proporcione të ndryshueshme”.
6. Përbërësit që përbëjnë më pak se 2% të produktit përfundimtar.	Mund të renditen në rend të ndryshëm pas përbërësve të tjerë.
7. Përbërësit e ngjashëm apo të zëvendësueshëm në mënyrë reciproke, me gjasa për t’u përdorur në prodhimin apo përgatitjen e një produkti ushqimor pa ndryshuar përbërjen, natyrën apo vlerën e këtij produkti ushqimor dhe në rast se përbëjnë më pak se 2% të produktit përfundimtar.	Mund të referohen në listën e përbërësve me anë të deklaratës “përmban ...dhe/ose ...”, ku të paktën një prej jo më shumë se dy përbërësve është i pranishëm në produktin përfundimtar. Kjo dispozitë nuk zbatohet për aditivët ushqimorë ose përbërësit e renditura në pjesën C të kësaj shtojce dhe për substancat ose produktet e renditura në shtojcën II që shkaktojnë alergji ose intoleranca.
8. Vajrat e rafinuara me origjinë bimore.	Mund të grupohen së bashku në listën e përbërësve nën emërtimin “vajra bimore” të ndjekura menjëherë nga lista e deklarimeve të origjinës specifike bimore, si dhe mund të ndiqen nga fjalia “në proporcione që ndryshojnë”. Nëse grupohen së bashku, vajrat bimore përfshihen në listën e përbërësve në përputhje me nenin 18, pika 1, në bazë të peshës totale të vajrave bimore të pranishme. Shprehja “i hidrogjenizuar plotësisht” ose “pjesërisht i hidrogjenizuar”, sipas rastit, duhet të shoqërojë deklarimin e vajit të hidrogjenizuar.
9. Yndyrat e rafinuara me origjinë bimore.	Mund të grupohen së bashku në listën e përbërësve nën emërtimin “yndyrna bimore” të ndjekura menjëherë nga lista e deklarimeve të origjinës specifike bimore, si dhe mund të ndiqen nga fjalia “në proporcione që ndryshojnë”. Nëse grupohen së bashku, yndyrnat

	<p>bimore përfshihen në listën e përbërësve në përputhje me nenin 18, pika 1, në bazë të peshës totale të yndyrave bimore të pranishme.</p> <p>Shprehja “i hidrogjenizuar plotësisht” ose “pjesërisht i hidrogjenizuar”, sipas rastit, duhet të shoqërojë deklarinin e yndyrës së hidrogjenizuar.</p>
--	---

PJESA B
EMËRTIMI I PËRBËRËSVE TË CAKTUAR ME EMRIN E KATEGORISË
PËRVEÇ EMRIT SPECIFIK

Pa cenuar nenin 21, përbërësit që i përkasin njëres prej kategorive të renditura më poshtë dhe që janë elemente të një produkti ushqimor tjetër mund të emërtohen sipas emrit të kësaj kategorie se sa me emrin specifik.

Përkufizimi i kategorisë së produkteve ushqimore	Emërtimi
1. Vajrat e rafinuara me origjinë shtazore	“Vaj”, së bashku me mbiemrin “shtazor” ose deklarinin e origjinës specifike shtazore. Shprehja “i hidrogjenizuar plotësisht” ose “pjesërisht i hidrogjenizuar”, sipas rastit, duhet të shoqërojë deklarinin e vajit të hidrogjenizuar.
2. Yndyrat e rafinuara me origjinë shtazore	“Yndyrë”, së bashku me mbiemrin “shtazor” ose deklarinin e origjinës specifike shtazore. Shprehja “i hidrogjenizuar plotësisht” ose “pjesërisht i hidrogjenizuar”, sipas rastit, duhet të shoqërojë deklarinin e yndyrës së hidrogjenizuar.
3. Përzierje mielli të përfutuara nga dy ose më shumë lloje drithërash	“Miell”, ndjekur nga një listë drithërash nga të cilat është përftuar, në rend zbritës në peshë.
4. Niseshte dhe niseshte e modifikuar nga metoda fizike ose nga enzima	“Niseshte”
5. Të gjitha llojet e peshkut, ku peshku përmban një përbërës të një produkti tjetër ushqimor dhe me kusht që emri dhe paraqitja e këtij produkti ushqimor të mos i referohet llojit specifik të peshkut	“Peshk”
6. Të gjitha llojet e djathit, ku djathi ose djathi i përzier përmban një përbërës të një produkti tjetër ushqimor dhe me kusht që emri dhe paraqitja e këtij produkti ushqimor të mos i referohet llojit specifik të djathit	“Djathë”
7. Të gjitha erëzat që nuk tejkalojnë më shumë se 2% në peshën e produkteve ushqimore	“Erëza” ose “përzierje erëzash”
8. Të gjitha barërat ose pjesë barërash që nuk tejkalojnë më shumë se 2% në peshën e produkteve ushqimore	“Barëra” ose “përzierje barërash”
9. Të gjitha llojet e përgatitjeve të gomës të përdorura në prodhimin e bazës së gomës për çamçakëz	“Bazë gome”
10. Të gjitha llojet e produkteve të drithërave të pjekura dhe të thërrmuara	“Tul” ose “peksimadhe”, sipas rastit
11. Të gjitha llojet e sukrozës	“Sheqer”

12. Dekstrozë anhidrike ose dekstrozë monohidrate	“Dekstrozë”													
13. Shurup glukoze dhe shurup glukoze anhidrike	“Shurup glukoze”													
14. Të gjitha llojet e proteinave të qumështit (kazeina, kazeinate dhe proteina e hirrës) dhe përzierje të tyre	“Proteina qumështi”													
15. Gjalpë kakaoje i presuar, i shtrydhur ose i rafinuar	“Gjalpë kakaoje”													
16. Të gjitha llojet e verës	“Vera”													
17. Muskujt e skeletit të gjitarëve dhe llojet e zogjve të njohur si të përshtatshme për konsum njerëzor me inde të përfshira ose të përcaktuara në mënyrë natyrale, ku përmbajtja e yndyrave totale dhe indeve lidhëse nuk kalon vlerat e treguara më poshtë dhe kur mishi është përbërës i një produkti ushqimor tjetër. Përmbajtja maksimale e yndyrës dhe e indeve lidhëse për përbërësit e emërtuar me termin “... mish”	“... mish” dhe emrat e llojeve të kafshëve nga të cilat ai vjen													
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Speciet</th> <th>Përmbajtja e yndyrës</th> <th>Raporti kolagjen/proteina të mishit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>- Gjitarët (përveç lepujve dhe derrave) dhe përzierjeve të llojeve ku mbizotërojnë gjitarët</td> <td>25%</td> <td>25%</td> </tr> <tr> <td>- Derrat</td> <td>30%</td> <td>25%</td> </tr> <tr> <td>- Zogjtë dhe lepujt</td> <td>15%</td> <td>10%</td> </tr> </tbody> </table>	Speciet	Përmbajtja e yndyrës	Raporti kolagjen/proteina të mishit	- Gjitarët (përveç lepujve dhe derrave) dhe përzierjeve të llojeve ku mbizotërojnë gjitarët	25%	25%	- Derrat	30%	25%	- Zogjtë dhe lepujt	15%	10%	
Speciet	Përmbajtja e yndyrës	Raporti kolagjen/proteina të mishit												
- Gjitarët (përveç lepujve dhe derrave) dhe përzierjeve të llojeve ku mbizotërojnë gjitarët	25%	25%												
- Derrat	30%	25%												
- Zogjtë dhe lepujt	15%	10%												
Në qoftë se këta kufij maksimalë janë tejkaluar, por të gjitha kriteret e tjera për përkufizimin e “mishit” janë plotësuar, përmbajtja e “... mishit” duhet rregulluar me ulje përkatësisht dhe në listën e përbërësve duhet të përmendet, përveç termit “... mish” dhe prania e yndyrës dhe/ose indit lidhës. Produktet e mbuluara nga përkufizimi “mish i paketuar mekanikisht” përjashtohen nga ky përkufizim.														
18. Të gjitha llojet e produkteve të mbuluara nga përkufizimi “mish i paketuar mekanikisht”.	“Mish i paketuar mekanikisht” dhe emrat e llojeve të kafshëve nga të cilat ai vjen.													

PJESA C

EMËRTIMI I PËRBËRËSVE TË CAKTUAR ME EMRIN E KATEGORISË SË TYRE TË NDJEKUR NGA EMRI SPECIFIK OSE NUMRI I TYRE E

Pa cenuar nenin 21, aditivët ushqimorë dhe enzimat ushqimore të ndryshme nga ato të specifikuar në pikën “b”, të nenit 20, që i përkasin një prej kategorive të renditura në këtë pjesë, duhet të emërtohen sipas emrit të kësaj kategorie, të ndjekura nga emri i tyre specifik, sipas rastit, nga numri E. Nëse një përbërës i përket më shumë se njëres prej këtyre kategorive, atëherë duhet të tregohet kategoria e përshtatshme për funksionin fillestar, në rastin e produktit ushqimor në fjalë:

- Acid;
- Rregullator aciditeti;
- Agjent fryrës;
- Agjent antishkumues;
- Antioksidant;
- Agjent rritës;
- Ngjyra;
- Emulsifikues;
- Kripëra emulgatorë;
- Agjent i qëndrueshëm;
- Shtues të aromës;
- Agjent të trajtimit të miellit;

Agjent shkumues;
Agjent xhelformues;
Agjent glazues;
Krijues lagështie;
Niseshte e modifikuar;
Konservues;
Gaz shtytës;
Agjent fryrës;
Izolues;
Stabilizues;
Ëmbëlsues;
Trashës.

PJESA D EMËRTIMI I AROMATIZUESVE NË LISTËN E PËRBËRËSVE

1. Substancat aromatizuese emërtohen nga termat:

- “Aromatizues” ose me një emër ose përshkrim më specifik të substancës aromatizuese nëse përbërësi aromatizues përmban aromatizues siç përcaktohen në pikat “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “h” të pikës 3, të udhëzimit nr. 7, datë 14.12.2015, “Për aromatizuesit dhe përbërës të caktuar ushqimorë me veti aromatizuese, të përdorur në prodhimin e produkteve ushqimore”;

- “Aromatizues me erë tymi” ose “aromatizues me erë tymi të prodhuar nga ushqime ose kategori ose burime ushqimore” (p.sh., aromatizues me erë tymi i prodhuar nga ahu), nëse përbërësi aromatizues përmban aromatizues siç përcaktohen në germën “dh” të pikës 3, të udhëzimit nr. 7, datë 14.12.2015 “Për aromatizuesit dhe përbërës të caktuar ushqimorë me veti aromatizuese, të përdorur në prodhimin e produkteve ushqimore” dhe i përçon ushqimit një aromë tymi.

2. Termi “natyral” për përshkrimin e aromatizuesve duhet të përdoret sipas kreut IV, pika B e udhëzimit nr. 7, datë 14.12.2015, “Për aromatizuesit dhe përbërës të caktuar ushqimorë me veti aromatizuese, të përdorur në prodhimin e produkteve ushqimore”.

3. Kuinina dhe/ose kafeina e përdorur si aromatizuese në prodhimin ose përgatitjen e një produkti ushqimor përmendet sipas emrit në listën e përbërësve menjëherë pas termit “aromatizues”.

PJESA E EMËRTIMI I PËRBËRËSVE TË PËRBËRË

1. Një përbërës i përbërë mund të përfshihet në listën e përbërësve, me emërtimin e tij për sa kohë që kjo përcaktohet sipas ligjit ose sipas traditës, në lidhje me peshën e tij të përgjithshme dhe ndiqet menjëherë nga një listë përbërësish.

2. Pa cenuar nenin 21, lista e përbërësve për përbërësit e përbërë nuk është e detyrueshme:

a) Kur përbërja e përbërësve të përbërë përcaktohet në dispozitat ekzistuese të legjislacionit në fuqi dhe kur përbërësi i përbërë është më pak se 2% i produktit përfundimtar; megjithatë, kjo dispozitë zbatohet për aditivët ushqimorë sipas pikave “a” deri në “d” të nenit 20;

b) Për përbërësit e përbërë që kanë në vetvete një përzierje erëzash dhe/ose barërash që janë më pak se 2% e produktit përfundimtar, me përjashtim të aditivëve ushqimorë, sipas pikave “a” deri në “d” të nenit 20; ose

c) Kur përbërësi i përbërë është një produkt ushqimor për të cilin lista e përbërësve nuk është e nevojshme sipas legjislacionit ekzistues të BE-së.

SHTOJCA VIII TREGUESIT SASIORË TË PËRBËRËSVE

1. Treguesi sasiar nuk është i nevojshëm:

a) Për një përbërës ose kategori përbërësish:

I. Pesha neto e lëndës së thatë e të cilëve përcaktohet në përputhje me pikën 5 të shtojcës IX;

II. Sasitë e të cilëve janë kërkuar të shfaqen më parë në etiketim sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi;

III. Të cilët përdoren në sasi të vogla për qëllim aromatizimi; ose

IV. Të cilët, kur paraqitja me emrin e produktit ushqimor nuk është e tillë që të drejtojë zgjedhjen e konsumatorit në vendin e tregtimit, sepse ndryshimi në sasi nuk është thelbësor për të karakterizuar produktin ushqimor ose nuk e dallon atë nga produkte ushqimore të ngjashme;

b) Kur dispozitat specifike të legjislacionit në fuqi e përcaktojnë saktësisht sasinë e një përbërësi ose një kategorie përbërësish pa pasur nevojë të tregohet në etiketë; ose

c) Në rastet e cituara në pikat 4 dhe 5 të pjesës A, të shtojcës VII.

2. Pikat “a” dhe “b” të nenit 22, pika 1 e këtij vendimi nuk zbatohen:

a) Në rastin kur çdo përbërës ose kategori përbërësish të mbuluar nga tregues “me ëmbëlsues” ose “me sheqerna dhe sheqerna diabetikë”, nëse ky tregues shoqëron emrin e produktit ushqimor, në përputhje me shtojcën III; ose

b) Në rastin e çdo vitamine ose minerali të shtuar, nëse kjo substancë është subjekt i deklaratës së vlerave ushqimore.

3. Treguesi i sasisë së një përbërësi ose kategorie përbërësish:

a) Shprehet si përqindje, e cila përkon me sasinë e përbërësit ose përbërësve në kohën e përdorimit të tij/tyre; dhe

b) Vendoset në ose menjëherë pas emrit të produktit ushqimor ose në listën e përbërësve në lidhje me përbërësin ose kategorinë e përbërësve në fjalë.

4. Duke përjashtuar pikën 3:

a) Nëse produktet ushqimore kanë humbur lagështinë si pasojë e trajtimeve me nxehtësi apo trajtimeve të tjera, sasia duhet të shprehet në përqindje e cila duhet të përkojë me sasinë e përbërësve të përdorur, në lidhje me produktin përfundimtar, përveç nëse kjo sasi ose sasia totale e të gjithë përbërësve të treguar në etiketë, tejkalon 100%, rast në të cilin sasia tregohet në bazë të peshës së përbërësve të përdorur për të përgatitur 100 g të produktit përfundimtar;

b) Sasia e përbërësve të avullueshëm tregohet në bazë të proporcionit të tyre sipas peshës së produktit përfundimtar;

c) Sasia e përbërësve të përdorur në formë të përqendruar apo të dehidratuar dhe të riformuluar gjatë prodhimit mund të tregohet në bazë të proporcioneve të tyre sipas peshës së regjistruar përpara përqendrimit ose dehidratimit;

d) Në rastin e produkteve ushqimore të përqendruara ose të dehidratuara të destinuara për t'u riformuluar me anë të shtimit të ujit, sasia e përbërësve mund të tregohet në bazë të proporcionit të tyre me peshën e produktit të riformuluar.

SHTOJCA IX DEKLARIMI I SASISË NETO

1. Deklarimi i sasisë neto nuk është i detyrueshëm në rastin e produkteve ushqimore:

a) Të cilat u nënshtrohen humbjeve të konsiderueshme në vëllim ose masë dhe që shiten në numër ose peshohen në prani të blerësit;

b) Sasia neto e të cilave është më pak se 5 g ose 5 ml; gjithsesi, kjo dispozitë nuk do të zbatohet për erëzat dhe barërat; ose

c) Që normalisht shiten me numër, me kusht që numri i artikujve të shihet qartë dhe të numërohet lehtë nga jashtë ose nëse kjo nuk është e mundur, të deklarohet në etiketë.

2. Kur treguesi i një lloji të caktuar sasië (p.sh., sasia nominale, sasia minimale, sasia mesatare) kërkohet nga dispozitat e legjislacionit në fuqi ose, kur nuk ka, nga dispozitat kombëtare, kjo sasi do të konsiderohet si sasia neto për qëllime të kësaj VKM-je.

3. Kur një njësi e parapaketuar përbëhet nga dy ose më shumë njësi individuale të parapaketuara që përmbajnë të njëjtën sasi të të njëjtit produkt, sasia neto tregohet duke cituar sasinë neto të çdo paketimi dhe numrin total të këtyre paketimeve. Deklarimi i këtyre veçorive, gjithsesi, nuk është i detyrueshëm kur numri total i paketimeve individuale mund të shihet qartë dhe mund të numërohet lehtë nga jashtë, si dhe kur të paktën një deklarim i sasisë neto të ndodhur në çdo paketim individual mund të shihet nga jashtë.

4. Kur një njësi e parapaketuar përbëhet nga dy ose më shumë paketime individuale të cilat nuk konsiderohen si njësi shitje, sasia neto jepet duke deklaruar sasinë totale neto dhe numrin total të paketimeve individuale.

5. Kur një ushqim i ngurtë vendoset në një mjedis të lëngshëm, duhet të deklarohet pesha neto e kulluar e produktit ushqimor. Kur produkti ushqimor është me glazurë, pesha neto e deklaruar e ushqimit duhet të jetë e përjashtuar nga glazura.

Për qëllim të kësaj pike, “mjedis i lëngët” janë të gjitha produktet e mëposhtme, në përzierje dhe, gjithashtu, të ngrira ose me ngrirje të shpejtë, me kusht që lëngu të jetë një shtesë ndaj elementeve kryesore të kësaj përgatitjeje dhe si i tillë të mos përbëjë një faktor përcaktues për blerjen: ujë, solucione ujore kripërash, shëllirë, solucione ujore të acideve ushqimore, uthull, solucione acide të sheqernave, solucione ujore të substancave të

tjera ëmbëlsuese, lëngje frutash ose perimesh në rast të frutave ose perimeve.

SHTOJCA X

DATA E JETËGJATËSISË MINIMALE, DATA “TË PËRDORET PARA” DHE DATA E NGRIRJES

1. Data e jetëgjatësisë minimale tregohet si vijon:

a) Data paraprihet nga fjalët:

- “Të përdoret përpara ...” ose “Të përdoret deri më ...” kur data përfshin deklarinimin e ditës,
- “Të përdoret përpara përfundimit ...” ose “Të përdoret deri në fund të (muaji/viti)” në raste të tjera,

b) Fjalët e cituara në pikën “a” shoqërohen nga:

- vetë data; ose
- një referencë e vendit ku është vendosur data në etiketë.

Nëse është e nevojshme, këto veçori shoqërohen nga përshkrimi i kushteve të ruajtjes, të cilat duhet të plotësohen nëse produkti do të ruhet për periudhën e specifikuar.

c) Data duhet të konsistojë në ditën, muajin dhe nëse është e mundur, në vitin në formë kronologjike dhe të pakoduar.

Në rastin e produkteve ushqimore:

- të cilat nuk ruhen për më shumë se 3 muaj, mjafton deklarinimi i ditës dhe i muajit;
- të cilat ruhen për më shumë se 3 muaj, por jo më shumë se 18 muaj, mjafton deklarinimi i muajit dhe i vitit;
- të cilat nuk ruhen për më shumë se 18 muaj, mjafton deklarinimi i vitit.

d) Sipas dispozitave të BE-së që vendosin lloje tjera të deklarinimit të datës, një deklarinim të datës së jetëgjatësisë minimale nuk është i nevojshëm për:

- frutat e freskëta dhe perimet, përfshirë patatet, që nuk janë qëruar, prerë ose trajtuar; kjo shmangie nuk zbatohet për farat e mbira dhe produktet e ngjashme, si bathët e mbira;

- verërat, verërat liker, verërat shkumëzuese, verërat e aromatizuara dhe produkte të ngjashme të përfutuara nga frutat, përveç rrushit, si dhe pijet që mbulohen nga kodi CN 2206 00 të përfutuara nga rrushi ose mushti i rrushit;

- pijet që përmbajnë 10% ose më shumë të vëllimit me alkool;

- produktet e furrës ose të pastičerisë, që, për shkak të natyrës së përmbajtjes, konsumohen normalisht brenda 24 orëve nga prodhimi i tyre;

- uthulla;

- kripa e gjellës;

- sheqeri i ngurtë;

- ëmbëlsirat, që përbëhen pothuajse vetëm nga sheqerna të aromatizuara dhe/ose të ngjyrosura;

- çamçakëzi dhe produktet e ngjashme për përlypjeje;

2. Data “të përdoret para” tregohet si vijon:

a) Paraprihet nga fjalët “të përdoret para ...”;

b) Fjalët në pikën “a” shoqërohen nga:

- vetë data; ose

- një referencë e vendit ku është vendosur data në etiketë.

Këto veçori ndiqen nga përshkrimi i kushteve të ruajtjes të cilat duhet të plotësohen;

c) Data duhet të konsistojë në ditën, muajin dhe nëse është e mundur, në vitin në formë kronologjike dhe të pakoduar;

d) Data “të përdoret para” tregohet në secilin porcion të parapaketuar.

3. Data e ngrirjes ose data e ngrirjes së parë siç përmendet në pikën 6, të shtojcës III, tregohet si vijon:

a) Paraprihet nga fjalët “Ngrirë më...”;

b) Fjalët e cituara në pikën “a” shoqërohen nga:

- vetë data; ose

- një referencë e vendit ku është vendosur data në etiketë,

c) Data duhet të konsistojë në ditën, muajin dhe nëse është e mundur, në vitin në formë kronologjike dhe të pakoduar.

SHTOJCA XI

LLOJET E MISHIT PËR TË CILËT DEKLARIMI I VENDIT TË ORIGJINËS OSE TË

PREJARDHJES ËSHTË I DETYRUESHËM

Kodet CN (Nomenklaturë e Kombinuar 2018)	Përshkrimi
0203	Mishi i derrave: i freskët, i ftohtë apo i ngrirë
0204	Mishi i deleve apo i dhive: i freskët, i ftohtë apo i ngrirë
0207	Mishi i shpendëve të buta të krerëve 0105: i freskët, i ftohtë apo i ngrirë

SHTOJCA XII
FORTËSIA ALKOOLIKE

Fortësia aktuale alkoolike sipas vëllimit të pijeve që përmbajnë më shumë se 1,2% të vëllimit të alkoolit tregohet me shifër jo më të madhe se një. Ajo ndiqet nga simboli “% vol.” dhe mund të paraprihet nga fjala “alkool” ose shkurtimi “alc”.

Fortësia alkoolike përcaktohet në 20°C.

Tolerancat e lejueshme pozitive dhe negative në lidhje me deklarimin e fortësisë alkoolike sipas vëllimit dhe të shprehur në vlera absolute renditen në tabelën e mëposhtme. Ato zbatohen pa cenuar tolerancat që rrjedhin nga metoda e analizës së përdorur për përcaktimin e fortësisë alkoolike.

Përshkrimi i pijes	Tolerancë pozitive ose negative
1. Birra me kodin CN 2203 00 që kanë fortësi alkoolike që nuk tejkalon 5,5% vol.; pijet e pagazuara me kodin CN 2206 00 të përfutuara nga rrushi	0,5% vol.
2. Birra me fortësi alkoolike që nuk tejkalon 5,5% vol.; pijet shumëzuese me kodin CN 2206 00 të përfutuara nga rrushi, sidërat, rakia e dardhës, verërat e frutave dhe të ngjashme, të përfutuara nga frutat përveç rrushit, gjysmëshumëzuese ose shkumëzuese; hidromeli	1 % vol.
3. Pije që përmbajnë fruta të zbutura ose pjesë bimësh	1,5% vol.
4. Çdo pije që përmban më shumë se 1,2% me volum alkooli	0,3% vol.

SHTOJCA XIII
SASI REFERUESE

PJESA A

SASI REFERUESE DITORE PËR VITAMINAT DHE MINERALET (TE TË RRRITURIT)

1. Vitaminat dhe mineralet të cilat mund të deklarohen dhe vlerat e tyre ushqyese referuese (NRV)

Vitaminë A (µg)	800
Vitaminë D (µg)	5
Vitaminë E (mg)	12
Vitaminë K (µg)	75
Vitaminë C (mg)	80
Tiaminë (mg)	1,1
Riboflavinë (mg)	1,4
Niacinë (mg)	16
Vitaminë B6 (mg)	1,4
Acid folik (µg)	200
Vitaminë B12 (µg)	2,5
Biotinë (µg)	50
Acid pantotenik (mg)	6
Kalium (mg)	2 000
Klorur (mg)	800
Kalcium (mg)	800
Fosfor (mg)	700
Magnez (mg)	375
Hekur (mg)	14
Zink (mg)	10
Bakër (mg)	1

Manganez (mg)	2
Fluorur (mg)	3,5
Selenium (µg)	55
Krom (µg)	40
Molibden (µg)	50
Jod (µg)	150

2. Sasi e konsiderueshme vitaminash dhe mineralesh

Si rregull, vlerat e mëposhtme merren parasysh në vendosjen e asaj që përbën sasinë e konsiderueshme:

- 15% e vlerave ushqyese referuese të specifikuar në pikën 1, të marra nga 100 g ose 100 ml në rastin e produkteve, përveç pijeve;
- 7,5% e vlerave ushqyese referuese të specifikuar në pikën 1 të marra nga 100 ml në rastin e pijeve; ose
- 15% e vlerave ushqyese referuese të specifikuar në pikën 1 për porcion nëse paketa përmban vetëm një porcion.

PJESA B

SASI REFERUESE PËR ENERGJINË DHE VLERAT E PËRZGJEDHURA USHQYESE PËRVEÇ VITAMINAVE DHE MINERALEVE (TE TË RRRITURIT)

Energjia dhe vlerat ushqyese	Sasi referuese
Energji	8 400 kJ/2 000 kcal
Yndyrna totale	70 g
Të ngopura	20 g
Karbohidrate	260 g
Sheqerna	90 g
Proteina	50 g
Kripë	6 g

SHTOJCA XIV

FAKTORËT E KONVERTIMIT

FAKTORËT E KONVERTIMIT PËR LLOGARITJEN E ENERGJISË

Vlera e energjisë që do të deklarohet, llogaritet me anë të faktorëve të mëposhtëm të konvertimit:

- Karbohidrate (përveç polioleve)	17 kJ/g-4 kcal/g
- Poliole	10 kJ/g-2,4 kcal/g
- Proteina	17 kJ/g-4 kcal/g
- Yndyrna	37 kJ/g-9 kcal/g
- Salatrime	25 kJ/g-6 kcal/g
- Alkool (etanol)	29 kJ/g-7 kcal/g
- Acid organik	13 kJ/g-3 kcal/g
- Fibra	8 kJ/g-2 kcal/g
- Eritrit	0 kJ/g-0 kcal/g

SHTOJCA XV

SHPREHJA DHE PARAQITJA E DEKLARATËS SË VLERAVE USHQYESE

Njësitë e matjes që do të përdoren në deklaratën e vlerave ushqyese për energjinë kiloxhaul (kJ) dhe kilokalori (kcal)) dhe për masën gramë (g), miligramë (mg) ose mikrogramë (µg) dhe rendi i paraqitjes së informacionit, sipas rastit, është si më poshtë:

Energji	kJ/kcal
Yndyra	g

nga të cilat:	
- të ngopura	g
- me një lidhje të pangopur	g
- me shumë lidhje të pangopura	g
Karbohidrate	g
nga të cilat:	
- sheqerna	g
- poliole	g
- niseshte	g
Fibër	g
Proteinë	g
Kripë	g
Vitamina dhe minerale	njësitë e specifikuar në pikën 1 të pjesës A, të shtojcës XIII